



**VIZITA** ► FAQE 4  
**Elivir Golemi**  
 refuzon takimin  
 me deputetët e  
 Kuvendit

**DENIMI I KOMBETARES**  
**UEFA LEGJITIMON**  
**DHUNEN E RACIZMIN,**  
**FSHF DO APELOJE**  
 ► FAQE 16



**KONFERENCA** ► FAQE 8-9  
**Rama:Ja si**  
 vendosëm që të  
 projektojmë gjinjtë  
 mbi Kryeministri

# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 VITI IV - NR. 252 - E SHTUNË - 25-10-2014




## EKSKLUZIVE

# ZBULOHET DOKUMENTI

## BIE ALIBIA E FULLANIT VJEDHJA U RREFYE NGA VETE BITRAJ

Zbardhet kallëzimi i plotë i ish-përgjegjësit të Thesarit që tregon se kur dhe si u vetëdenoncua ► FAQE 2-3



### Satirë politike



NGA **ARBEN DUKA**

Serbët, arrogantë, po Europa i mbështet!

► Në faqen 20 bashkë me një baladë

### Koment



NGA **GËZIM ZILJA**

Kur flet Halimi...

Jemi para një fakti të pamohueshëm që sistemi i drejtësisë në Shqipëri është thellësisht i korruptuar. Është një sistem hermetik, që këta 20 vjet ka shkatërruar çdo vlerë njerëzore në raport me drejtësinë dhe ka bërë që pjesa dërrmuese e qytetarëve të mos kenë më besim te ai. Të gjithë e pranojnë parimisht që sistemi i drejtësisë duhet reformuar, por deri sot jemi në vendnumër. Këtu vegohet përgjegjësia e madhe që ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë në këtë proces...

► vijon në faqen 19

### KREDIA

**Bode e Shehu**  
 si abuzuan  
 me afatet  
 e ofertave

► FAQE 5

### ARRESTIMI

**Ndërtimet pa**  
 leje, pranga  
 biznesmenit,  
 Fratari

► FAQE 11

### "NJERËZIT"

**Laguna e**  
 Patokut, mes  
 shkencëtarëve  
 e peshkatarëve

► FAQE 14

### PRONAT

**AKKP ja si do**  
 kompesohen  
 pronarët me  
 tokë të lirë

► FAQE 10

**BMC Blue Medical Center**  
 Vizita, Analiza & Diagnostikim  
 Të garantuara  
 sipas protokolleve të  
 mjekësisë bashkëkohore  
 nga Blue Medical Center

**Të parandalosh, më mirë se të kurosh!**

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë  
 Tel.: +355 4 2370 668  
 Cel: +355 66 20 90 008  
 Email: info@bmc.al, www.bmc.al

**Agjencia ANDE-LM®**  
 Agjencia ANDE-LM® ka kënaqësinë të prezantojë për herë të parë në Shqipëri Shkollën HTMI për prezantime direkte dhe intervista për Studim me Punësim të Siguruar në Zvicër. Shkolla HTMI është lider në Studime për Hoteleri-Turizëm dhe Përfaqësuesi i saj do jetë në Tiranë në datat **20-22 Tetor 2014**.  
 Të interesuarit për një takim të kontaktojnë në:  
**INFO@ANDE-LM.COM.AL** dhe **069 20 21 181**  
**JU MIRËPESIM!**

**HTMI**  
 Hotel and Tourism  
 Management Institute  
 Switzerland

**Academy Australasia**  
**ATC**  
 American Training Center

Agjencia ANDE-LM® në bashkëpunim me "American Training Center", ka kënaqësinë të prezantojë për herë të parë në Shqipëri Kursin OET, të duhur për Karrierë e Punësim në Fushën e Mjekësisë në Australi, Zelandë e Re, Singapor.


Kursi OET ofrohet nga Z. Matt Christie, Dekani i Akademisë Australasia, i cili vijon nga Melbourne enkas për jetë.

Kursi do të zhvillohet në Tiranë në datat **03-14 Nëntor 2014**. Rezervimi paraprakisht në **INFO@ANDE-LM.COM.AL** ose **069 20 21 181**.


Nëse doni të punoni në Australi, Zelandë e Re, Singapor në Mjekësi, OET është hallka e parë!

# » EKSKLUZIVE

**PËRGJEGJËSI I THESARIT** të Shtetit vjedhjen e tregoi para tre drejtorave, Çollakut, Sinanit dhe drejtorit juridik Altin Naqe. Më pas kërkoi takim me prokurorët



■ Faksimile e kallëzimit penal të depozituar në 21 korrik 2014 në prokurorinë e Tiranës nga juristi i Bankës së Shqipërisë Altin Naqe



# Bie alibia e Fullanit vjedhja u zbulua nga Bitraj e jo nga BSH

Zbardhet kallëzimi që tregon se Ardian Bitraj me vullnet deklaroi supervjedhjen në bankë

**VIDEO/ VJEDHJA E BSH, NE 5 NENTOR MASAT PER FULLANIN E GOLEMIN**


Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

bëra vetë nga shtetasi i kallëzuar Ardian Bitraj, ai ka përvetësuar shumat e mëdha monetare duke i tërhequr nga arka stok dhe nga arka për veprim dhe duke i fshehur nën çorape kur dilte nga ambientet e Bankës së Shqipërisë. Shtetasi i kallëzuar Ardian Bitraj me veprimet e tij ka kryer veprimet penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, parashikuar në nenin 300 dhe nenin 248 i Kodit Penal. Shtetasi i kallëzuar Ardian Bitraj, ka deklaruar vetë përpara drejtorit të Departamentit të Emisionit, Dorian Çollaku, Drejtorit të Departamentit Juridik, Altin Naqe, si dhe Drejtorit të Departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Eduard Sinani, se vlera monetare i ka përvetësuar i vetëm dhe se familja e tij dhe të tjerët të njohur dhe kolegë përveç të kallëzuarës Mimoza Bruzi nuk kanë dijeni për veprimet kriminale të kryer prej tij. Me të marrë dijeni rreth deklarimeve të shtetasit të kallëzuar Ardian Bitraj, u ngrit një komision për inventarizimin e vlerave monetare të arkës stok dhe të arkës për veprim, nga ku po rezultonte paraprakisht se në arkat e kontrolluara ka mungesa të mëdha të vlerave monetare. Shtetasi Ardian Bitraj ka pohuar se ai është përgjegjës i vetëm për vjedhjen e vlerave monetare që mungojnë nga inventari i arkave në ngarkim të tij. Sipas deklarimeve të të kallëzuarit, Ardian Bitraj, ai kishte biseduar me shtetasen Mimoza Bruzi se do të duhej të kallëzonte krimin e kryer pranë eprorëve të tij, pasi nuk mund të fshihet më ajo që kishte ndodhur meqenëse ishte planifikuar një inventar më i imtësishtë i vlerave monetare në ngarkim të të kallëzuarve në muajin korrik.

Sa më sipër kërkohet nga organi i Prokurorisë të fillojë menjëherë ndjekjen penale ndaj shtetasve Ardian Bitraj dhe Mimoza Bruzi për veprat penale për të cilat kallëzohet, duke vlerësuar se rrezikshmëria e veprave të kryera është shumë e lartë. Bashkëlidhur deklarimin e bërë vullnetarisht nga shtetasi Ardian Bitraj dhe procesverbale të datës 21.07.2014 të komisionit të inventarizimit të vlerave të arkës stok dhe arkës për veprim, informacionin i cili sjellim në vëmendjen se përmban të dhëna që përbëjnë sekret shtetëror.

**ELTON QYNO**  
TIRANË

Ish-përgjegjës i Arkës Stok, në Thesarin e Shtetit, Ardian Bitraj, është paraqitur me vullnet tek shefat e tij, ku ka deklaruar lidhur mbi skandalin e vjedhjes së 713 miliard lekëve nga Banka e Shqipërisë. Ky detaj që evidentohet në kallëzimin e datës 21 korrik 2014, hedh poshtë alibinë e ish-gubernatorit Fullani, se zbulimin e supervjedhjes e kishin bërë inspektorët e auditit të BSH. Dokumentat tregojnë se audit i bankës nuk ka pasur dijeni për vjedhjen, të paktën deri në datën 21 korrik të këtij viti, kur vetë i arrestuari Bitraj ka treguar fillimisht vjedhjen tek Drejtori i Qendrës së Emisionit Dorian Çollaku, dhe më pas është vënë në dispozicion të Prokurorisë së Tiranës.



më poshtë. Sot në datë 21.07.2014, jam vënë në dijeni nga Drejtori i Departamentit të Emisionit të BSH, se ka marrë sinjalizimin prej shtetit Ardian Bitraj, të kallëzuarit, se ai ka përvetësuar vlerave të mëdha monetare prej "Arkës Stok" dhe "Arkës për Veprime", që gjenden pranë Departamentit të Emisionit. Shtetasi i kallëzuar Ardian Bitraj, ka deklaruar se ka përvetësuar shumta të mëdha monetare qysh prej vitit 2010, për t'i përdorur për të luajtur bixhoz në lojra

fati dhe në llotari sportive. I kallëzuar Ardian Bitraj, ka qenë i ngarkuar me administrimin e vlerave monetare që disponoheshin pranë "arkës stok" dhe asaj "për veprim", gjithashtu ka përvetësuar vlera monetare edhe prej arkës stok kartëmonedhash dhe monedha metalike të dëmtuara, të cilat sipas urdhrit të administratorit të Bankës së Shqipërisë duhet të asgjësoheshin. Për veprimet e kryera prej shtetasit të kallëzuar Ardian Bitraj, sipas deklarimeve të këtij të

fundit, ka pasur dijeni edhe shtetasja Mimoza Bruzi, e cila nuk ka kallëzuar krimin e kryer nga i kallëzuar Ardian Bitraj. Shtetasja e kallëzuar Mimoza Bruzi, ka qenë gjithashtu e ngarkuar me administrimin e vlerave monetare të gjendura pranë arkës stok dhe arkës për veprim. Shtetasi i kallëzuar Ardian Bitraj, ka deklaruar se u detyrohet disa qendrave të lojra të fafit dhe basteve sportive në Tiranë shumta të mëdha monetare, përshkak të basteve të vendosura. Sipas deklarimeve të

**KALLËZIMI I PLOTË**  
Unë kallëzuesi duke mbajtur përgjegjësi penale për kallëzimin të rreme sipas nenit 305 të Koti Penal, depozitoj kallëzimin me shkrim si



NË FOTO: Ardian Bitraj duke hapur derën e kasafortës ku ndodhen lekët. Fotoja është nxjerrë nga kamerat e sigurisë, por në fakt askush s'e ka parë dhe të ndalojë Bitraj

**FOTOGRAFITË E KUTIVE TË HAPURA**



# Bitraj mbushi tetë kuti me topa spango dhe manuale bankare

Fotografitë e ekspertit kriminalist zbardhin sendet që zëvendësonin paratë e vjedhura në kuti

## Rekursi Fullani e Golemi në 5 nëntor në Gjykatën e Lartë për masën e sigurisë

Ish-Guvernatori, Adrian Fullani dhe vartësja e tij ish-inspektorja Elivir Golemi më 5 nëntor do të dalin para Gjykatës së Lartë për caktimin e masave të sigurisë. Gjykata e Lartë pasi shqyrtoi rekursin e Fullanit dhe Golemit ka vendosur që këto kërkesa të nënshtrihen gjykimit nga kolegji penal. Shorti ka zgjedhur si relator gjyqtarin Edmond Islamaj në gjykimin e Fullanit dhe gjykatësin Aleksandër Muska relator në procesin ndaj Elivir Golemit. Seancat ndaj ish-guvernatorit dhe ish-inspektore do të mbahen në të njëjtin kolegji me diferenca nga një orë midis tyre më 5 nëntor. Ishte Gjykata e Apelit ajo që ndryshoi masën e sigurisë për Fullanin duke e lënë atë me "arrest shtëpie" nga "arrest me burg" që vendosi gjykata penale e Tiranës, teksa për inspektorin Golemi e njëjta trupë gjyqësore në Apel vendosi ta lërë sërish në burg. Ish-inspektorja Elivir Golemi ndodhet pas hekurave së bashku me Ardian Bitrajn, Mimoza Bruzian dhe Klevis Bejtjan.




ELTON QYNO  
TIRANË

Gazeta "Shqiptarja.com" siguron të plotë dosjen e prokurorisë së Tiranës, në të cilën evidentohen me tabela fotografike 8 arkat me para të vjedhura nga Ardian Bitraj. Oficerë të prokurorisë dhe një ekspert i policisë kriminale kanë mundur të hyjnë brenda në ambientet e Thesarit duke kryer fotografimin e asaj që Bitraj, kishte mundur të kryente me shumë mjeshtri për rreth 4 vite me rradhë, duke mos u zbuluar nga eprorët e tij dhe inventarizuesit e BSH. Sot gazeta boton një pjesë të fotografive, ku tregohet se si nga arkat janë hequr shumta të konsiderueshme kartëmonedhash me preje 5000 lekë dhe në vend të tyre janë vendosur libra dhe topa spango. Veç këtyre materiale brenda në kuti, janë futur dhe manuale që vetë banka publikon si dhe një material me mbishkrimin "Libër i përpunimit të fondeve".

**TOPAT ME SPANGO**

Për Ardian Bitraj e rëndësishme ishte që kutia ku mbaheshin paratë të mos mbetet bosh, pas vjedhjes që ai kryente. Në 8 arkat që eksperti i policisë kriminale Fatos Konea ka fotografuar, ka pikasur se brenda në një arkë janë futur dhjetëra topa me spango. Në këtë arkë nuk është gjetur asnjë kartëmonedhë, pasi e gjitha ishte mbushur me topa spangoje. Në fotografimin që eksperti i bën të gjitha arkave del se në disa prej tyre janë futur dhe materiale të tjera si broshura të ndryshme, manuale, fletë palosje dhe libra. Të gjitha fotot janë pasqyruar në një tabelë fotografike nga eksperti i policisë kriminale, duke ia referuar më pas atë njësisë hetimore Task-Forcë, që drejton hetimet për skandalin e vjedhjes së 713 miliardë lekëve të vjetra nga dega

**Librat**  
Në krye të kutive janë gjetur libra, manual dhe sende të tjera, ndërkohë që në fund të kutisë ndodhej vetëm një sasi shumë e vogël kartëmonedhash prej 5000 lekëshe.



e Thesarit të Shtetit në Linzë. Fotografitë tregojnë se shumica e arkave të vjedhura nga Ardian Bitraj, janë të përgjysmuara nga lekët, ndërkohë që në disa prej tyre nuk është gjetur

asnjë kartëmonedhë. Në disa foto të publikuara nga "A1 Report", Bitraj shfaqet duke u dalë nga ambientet e zyrës së tranzitit të arkave, me një thes plastik të mbushur me para.

**Spango**

Pikërisht në këtë fotografi evidentohet se njëra nga tetë kuti që janë vjedhur nga Ardian Bitraj, ishte mbushur prej tij me topa spangoje.

Vizita

# Elivar Golemi refuzon takimin me deputetët e Kuvendit

## 3 deputetët në paraburgimin e grave, inspektoria e BSH s'i takon

ERVON KOÇI  
TIRANE

Ish-Kryeinspektoria e Bankës së Shqipërisë, Elivar Golemi ka refuzuar dje që të takohet me deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë takimit që anëtarët e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut zhvilluan në ambientet e paraburgimit në burgun 313 të Tiranës, ish-kryeinspektoria e BSH nuk takoi deputetët duke refuzuar që të jepet ankesat e saj lidhur me kushtet ku ndodhet edhe për masën e arrestit që është dhënë asaj.

**TAKIMI**  
Anëtarët e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë zhvilluan dje një takim me të paraburgosurit e burgut 313. Takimi ishte parashikuar në programin e punës të këtij nënkomisioni ku do të merrnin ankesat e të burgosurve, si edhe do të monitoronin e zbatimit të ligjit dhe të kushteve për këto persona që presin vendim formës së prerë nga gjykata. Deputetët e Kuvendit kishin përgatitur një tryezë ku të gjithë personat që vuajnë dënimin në paraburgim kishin të drejtë që të zhvillonin një takim me ata. Por ish-kryeinspektoria e Banës së Shqipërisë refuzoi

Ekspertët



**Hysi**  
Nënkomisioni për të drejtat e Njeriut drejtohet nga deputetja Hysi e cila ka udhëhequr dje edhe të gjithë aktivitetin e zhvilluar në ambientet e paraburgimit të grave në burgun 313



**Burgu**  
Ish-kryeinspektoria e BSH ndodhet në ambientet e paraburgimit prej rreth dy muajsh, ku ka apeluar vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës në Gjykatën e Shkallës së Lartë



Elivar Golemi

zoi që të zhvillonte takimin me deputetët. Burime nga takimi pohuan për gazetën "Shqiptarja.com" se në takim nuk kishte vajtur e arrestuara VIP e burgut duke refuzuar që t'i paraqiste atyre ankesat mbi situatën në të cilën ndodhet në burg.

**QËNDRIMI**  
Pas një vizite në burgun 313 në seksionin e grave, së bashku me disa anëtarë të tjerë të nënkomisionit parlamentar "Për të drejtat e njeriut", deputetja Vasilika Hysi u shpreh se gjatë monitorimit janë ndeshur me një

sërë problemesh që duhet të zgjidhen. "Ne kemi konstatuar një sërë problemesh të cilat nuk adresohen të gjitha vetëm për sistemin e burjeve, por kanë të bëjnë edhe me Prokurorinë, me sistemin gjyqësor, avokatinë me shërbimet sociale, po

edhe me ne politikbërësit, pra se si i hartojmë ligjet dhe se si i kemi ndryshuar ligjet. Lidhen probleme me kushtet në paraburgim, lidhen probleme me mbipopullimin për shkak edhe të politikës penale", - tha Hysi. Aktualisht në burgjet

shqiptare ndodhen 5 100 të burgosur, sipas shifrave të Drejtorisë së Burjeve, teksa kushtet e vështira në këto institucione janë ngritur si shqetësim edhe më parë në media, ku nuk kanë munguar dhe denoncimet nga vetë të burgosurit.

Vendimi

Ish-kryeinspektoria e Bankës së Shqipërisë ka marrë masën e arrestit me burg nga Gjykata e Shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit dhe e ka apeluar masën në Gjykatën e Lartë

Programi

### Monitorimi i radhës në paraburgimin e 302

Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut do të zhvillojë një seancë tjetër monitoruese në ambientet e paraburgimit. Në kalendarin e punimeve është parashikuar që vizita e radhës të bëhet në burgun e të miturve ku do të shihen kushtet në të cilat qëndrojnë personat në paraburgim. Konkretisht sipas kalendarit është parashikuar që në datën 11 nëntor të bëhet monitorimi i kushteve në paraburgimin e burgut 302 në Tiranë, institucion ku vuajnë dënimet të miturit.


Monitorimi  
TIRANE

# Burgjet, raport në Kuvend për situatën në paraburgimet

Vasilika Hysi: Do të hartojmë raportin që do ja paraqesim Komisionit të Ligjeve

Nënkomisioni për të drejtat e njeriut do të përpilojë një raport i cili do t'i paraqitet Komisionit të Ligjeve për miratim. Sipas programit të punës është përcaktuar se të gjitha shkeljet e konstatuara nga monitorimi që do të kryhet do të përpilohen në një raport të caktuar ku do të shkojë për miratim me pas në Kuvend. Gjatë monitorimit të parë të zhvilluar dje deputetët e evidentuan disa probleme, ku kryesor ishte mbipopullimi i paraburgimit. Lidhur me këto çështje, kryetarja e nënkomisionit, Vasilika Hysi theksoi se në përfundim të programit të punës, raporti do t'i shkojë Komisionit të Ligjeve ku do të jepen edhe rekomandimet për institucionet përkatëse. Hysi theksoi se paraprakisht janë marrë masa për përmirësimin e kushteve në paraburgimin e grave në burgun 313 të Tiranës, por do të jepen edhe rekomandimet

përkatëse për disa institucione në mënyrë që të zbatohen të gjitha kushtet për personat që vuajnë dënimin në këto institucione. "Së shpejti ne do bëjmë një raport, i cili do të diskutohet në komisionin e ligjeve dhe do adresojmë të gjitha rekomandimet institucioneve përkatëse", tha deputetja Vasilika Hysi pas përfundimit të vëzhgimit në ambientet e paraburgimit. Këto rekomandime pritet që të shkojnë për Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve etj pasi janë edhe institucionet kompetente në administrimin e sistemit të burjeve në Shqipëri.



Vasilika Hysi

SHITJE ME ANKANDIN E PARË  
NGA STUDIO PËRMBARIMORE L.D.C

Përshkrimi i pasurisë:

1. "Shtëpi 4-katëshe me oborr", me regjistrim në Regjistrin Hipotekor Nr. 292, datë 23.05.2002, e ndodhur në Zonën Kadastrale 8270, Regjistruar në Zyrën Vendore Regjistrimit Pasurive Paluajtshme Tiranë, me sip. totale 684 m<sup>2</sup>, Kufizuar nga veriu me pasurinë Nr. nga jugu me pasurinë Bexhet Ypit, nga lindja me pasurinë S.Lunikut, nga perëndimi me pasurinë N. Jakoves

Çmimi për shitje është 498.400 Euro (katër qind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind) Euro.

Data e shpalljes 14.10.2014

Data e zhvillimit 28.10.2014 deri në orën 16.<sup>00</sup>

Ankandi zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Përmbarimore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8, Kati 1, Tiranë, e-mail lefter.canaj@yahoo.com

SHITJE ME ANKANDIN E DYTË  
NGA STUDIO PËRMBARIMORE L.D.C

Përshkrimi i pasurisë:

1. Ambient i ndodhur në katin e përdhe", me Nr. Pasurive 8/170, e ndodhur në Tiranë, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8220, regjistër hipotekor nr. 79, datë 25.09.2002, me sipërfaqe 230 m<sup>2</sup>.

Çmimi i ri për shitje është 5.096.000 Lekë (pesë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.


Data e shpalljes 10.09.2014

Data e zhvillimit 06.11.2014 deri në orën 16.<sup>00</sup>

Ankandi zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Përmbarimore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8, Kati 1, Tiranë, e-mail lefter.canaj@yahoo.com

## Hetimet

Muxhahedinët  
shqiptarë dërguan  
tre femra në  
luftimet siriane



Të arrestuarit si të dyshuar apo ata, që janë shpallur në kërkim për dërgimin e luftëtarëve shqiptarë në zonat e nxehta, do të përballen edhe me akuzën për dërgimin e tre vajzave në kampet e xhihadistëve në Siri. Sipas informacioneve dhe provave të siguruar nga prokuroria, mësohet, se ndaj dy të arrestuarve dhe një tjetri në kërkim, emrat e të cilëve nuk bëhen të ditur për arsye hetimi, ka nisur verifikimi edhe për dërgimin e tre vajzave nga Shqipëria në zonën e luftës. Sipas këtyre burimeve, mësohet se provincën veriore siriane, konkretisht në qytetin e Raqas, ku edhe ndodhet kampi i ushtarëve xhihadistë kanë përfunduar një vazhje nga Tirana, një nga Pogradeci, dhe tjetra nga Shkodra. Mësohet, se njëra prej tyre është mashtruar me premtimin, se do të vazhonte studimet në Bursa të Turqisë, por e ka parë veten në kampin e ushtarëve të Xhabaht Al-Nusra. Ndërsa dy femrat e tjera, janë njëra gruaja e një shqiptari të vrarë gjatë luftimeve dhe tjetra e dërguar nga bashkëshorti së bashku me fëmijën. Të treja, sipas burimeve të prokurorisë, shfrytëzohen në kamp nga luftëtarët xhihadistë. Mësohet se nga bisedat me familjarët e tyre, ato kanë treguar edhe për kushtet e këqija ku ndodhen dhe trajtimin që u bëhet në kamp, madje njëra prej tyre mendohet, se ka mbetur shtatzënë dhe kërkon të kthehet në Shqipëri.

# Bode e Shehu si abuzuan me afatet e ofertave të kredisë

Task-Forca zbardh kallëzimin e ministrisë. Bankave ju la 3 ditë kohë për dërgimin e ofertave të kredisë

ELTON QYNO  
TIRANE

**Z**bardhet skema se si ish-ministri i Financave Ridvan Bode dhe ish-zv/ministri Sherefedin Shehu kanë kryer veprimet e pabarazisë në tendera, për marrjen e një kredie prej 250 milionë euro nga një bankë gjermane dhe greke. Aktualisht për këtë çështje njësisia hetimore Task-Forcë në prokurorinë e Tiranës ka nisur hetimet duke rregjistruar vetëm dy akuzat atë të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Pabarazisë në tendera dhe ankande publike". Sipas burimeve pranë prokurorisë së Tiranës, në kallëzimin e saj ministria e Financave pretendon se dy të kallëzuarit kanë shkelur ligjin, për shkak se kanë përdorur standarde të dyfishta, lidhur me caktimin e afatit kohor tek bankat ku është kërkuar ta merrej kredia.

## AFATI 7 DITOR

Në kallëzim pretendohet se për disa banka nga ish-titullarët e ministrisë është lënë një afat kohor deri në tre ditë për të depozituar pranë dikasterit

**Interesi**  
Prokurorët tregojnë se norma e interesit që është marrë kredia prej 250 milionë euro është brenda kontureve të legjislacionit shqiptar.



të financave ofertat e kredive, ndërkohë që për dy bankat "Alpha Bank" dhe "Deutsche Bank", është lënë një afat 7 ditor. Nisur nga kjo situatë njësisia hetimore Task-Forcë ka nisur verifikimet për dy deputetët e Partisë Demokratike. Burimet thonë se nëse shkeljet e tyre janë të karakterit penal, atëherë dosja do i kalojë për hetim Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka kompetencën ligjore për hetimin e njerëve me imunitet. Ndërkohë që një tjetër shkelje që pretendohet në kallëzimin e ministrisë së Financave

është fakti se pse kjo kredi është marrë me një shifër mjaft të lartë interesi në 13.3 për qind. Kjo sipas tyre i ka shkaktuar një dëm financiar buxhetit të shtetit. Nga ana tjetër prokurorët tregojnë se norma e interesit që është marrë kredia prej 250 milionë euro është brenda kontureve të legjislacionit shqiptar.

## BORXHI MË I SHTRËNJTË

Sipas kallëzimit shkelje nuk janë vetëm vlerësimi i ofertave, por dhe procesi është i padokumentuar, i pabarabartë, jo transparent dhe

në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi. "Kriteret janë ndryshuar gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, pasi është konstatuar se ofertuesi i preferuar kishte paraqitur borxhin më të shtrenjtë nga gjithë të tjerët. Përveçse një borxh shumë i shtrenjtë me kosto reale rreth 13.3%, si pasojë e veprimeve të mësipërme dhe duke blerë borxhin më të shtrenjtë midis gjithë ofertave të paraqitura, i është shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në vlerën 60 milionë euro" -thuhet në kallëzimin e ministrisë, që sot drejtohet nga Shkëlqim Cani.

## LAJME shkurt



Ndalohen  
45 klandestinë në  
kufi me Greqinë

— Policia e Gjirokastrës ka ndaluar mbrëmjen e djeshme 45 klandestinë nga disa vende të Afrikës. Efektivët blu kanë arritur të zbulojnë klandestinët të cilët ishin të fshehur në një pyll pranë Kakavijës. 39 prej klandestinëve mësohet se janë nga Siria, 4 nga Nigeria dhe 1 nga Kongo. Sipas policisë, në mesin e klandestinëve të ndaluar 2 janë gra, ku njëra është shtatzënë, si dhe një fëmijë i mitur. Ata mendohet se kanë ardhur nga Greqia dhe si destinacion kishin një nga vendet e Evropës.

Përdori invaliden  
për të mos  
paguar taksa

— Një 60-vjeçar është arrestuar ditën e djeshme nga Policia e Elbasanit nën akuzën e mashtrimit, pasi ka përdorur emrin e një invalideje pa dënimin e saj, në mënyrë që të mos paguante taksat e makinës. I arrestuari Veli Kumrija kishte bërë dokumentet e makinës në emrin e invalideje për të shmangur detyrimin e taksës vjetore, çka me ligj nuk paguhet nga invalidët. E gjithë kjo është bërë pa dënimin e të verbrës. 60-vjeçari Veli Kumrija akuzohet për mashtrim dhe falsifikim të dokumentave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMEVE



## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit:

**"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit të degëve të Bankës së Shqipërisë"**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i Hapur Kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,710,000 Lekë.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: ish-Hotel Dajti, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 042235576, çdo ditë nga ora 10.00 - 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 2.000 lekësh, në Sektorin e Financës të Bankës së Shqipërisë, që ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla B.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 20 Nëntor 2014, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Sheshi "Avni Rustemi", Nr 24, Tiranë. Tel: +355-4-241 9301/02/03, +355-4-241 9409/10/11,

Faks: +355-4-241 9408;

e-mail: public@bankofalbania.org;

www.bankofalbania.org

## Në Rinas

Kosovari me pasaportë  
false, pranga 4 personave

— Një qytetar kosovar është arrestuar dje në aeroportin Nënë Tereza në Rinas, pasi ka tentuar të kalojë kufirin duke përdorur një pasaportë shqiptare biometrike. Jetmir Krasniqi, mbante me vete pasaportën e një qytetari nga Shqipëri, duke shfrytëzuar ngjashmërinë që kishte me të. Policia tha se, Krasniqi e kishte blerë pasaportën biometrike tek Taulant Shtyti, nga Laçi, i cili është identifikuar dhe arrestuar nga policia. Kosovari që tentoi të kalonte kufirin me pasaportë shqiptare, është ndihmuar dhe nga 3 persona të tjerë



të cilët po ashtu janë arrestuar. Tre bashkëpunëtorët e Krasniqit, janë Valter Meshi nga Tropoja, Marsel Kasmi dhe Taulant Shtyti, të dy nga Laçi, ky i fundit poseduesi i pasaportës biometrike që mbante Krasniqi.

■ **BASHKIA**

Bashkia e Tiranës i bën thirrje deputetëve të Tiranës të mos mbrojnë paligjshmërinë. Shkatërrimet selektive të Ramës po mbyllin qindra vende pune

■ **POLICIA**

Prej disa javësh Policia e Shtetit ka ndërmarrë një aksion për ndalimin e ndërtimeve pa leje duke proceduar deri më tani me disa qindra raste

# Pranga biznesmenit, Fratari, akuzohet për ndërtime pa leje

Mesditën e djeshme është arrestuar Hajredin Fratari. PD akuzon për hakmarrje, familja: Jo politikë



Hajredin Fratari

2

**Pallate**

Biznesmeni i ndërtimit, Hajredin Fratari akuzohet se ishte duke ndërtuar dy pallate pa leje në zonën e Selitës së Vjetër në Tiranë.

20

**Tetor**

Që në këtë datë Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kishte kërkuar pezullimin e ndërtimeve në objektet e ndërtuesit Fratari.

**ARTAN CENA**  
TIRANË

**B**iznesmeni i njohur i ndërtimeve, Hajredin Fratari, 72 vjeç është vënë në pranga mesditën e djeshme nga Policia e Tiranës pasi akuzohet për ndërtime pa leje. INUK kishte kërkuar në 20 tetor pezullimin e punimeve pasi kishin përfunduar lejet. Arrestimi ka sjellë dhe reagime politike nga ana e Partisë Demokratike, të cilët e kanë cilësuar si hakmarrje arrestimin e biznesmenit. Por kundër kësaj deklarate kanë qenë familjarët e biznesmenit dhe avokati i tij, Aranit Roshi. Ky i fundit tha për Shqiptarja.com se, arrestimi nuk ka të bëjë me politikën. Gjithashtu Roshi theksoi se, "dokumentet për ndërtimet janë të gjithë të rregullta". Arrestimi i Fratarit është bërë mesditën e djeshme në një prej objekteve të tij në zonën e Selitës së Vjetër në kryeqytet. Ai ishte duket ndërtuar këtu dy pallate, që sipas Policisë së Tiranës janë pa leje. Uniformat blu kanë bërë të ditur se, Hajredin Fratari ishte në hetim prej 6 muajsh pikërisht për ndërtime pa leje.

Komisariatit Nr 1 në kryeqytet. A1 Report ka siguruar edhe pamje të kompleksit të pallateve që Fratari po ndërton në Selitë të Vjetër.

**AKUZAT NDAJ BIZNESMENIT**

Për policinë, arrestimi i biznesmenit Fratari është bërë në kuadër të evidencimeve dhe ndalimit të ndërtimeve

**Hetimet**

Uniformat blu kanë bërë të ditur se, Hajredin Fratari ishte në hetim prej 6 muajsh pikërisht për ndërtime pa leje. Policia ka bërë të ditur se, ka të gjitha provat në lidhje me akuzën e ngritur.

pa leje në Tiranë. Burime nga uniformat blu thanë se, Fratari e ka kaluar natën në dhomat e paraburgimit të komisariatit numër 1 në kryeqytet. Prej disa javësh Policia e Shtetit ka ndërmarrë një aksion për ndalimin e ndërtimeve pa leje duke proceduar deri më tani me disa qindra raste. Aksioni i policisë nisi pasi iu deleguan disa kompetenca të INUK.

Ndërkaq, Inspektoratit Urbanistik Kombëtar që në datën 20 tetor kishte kërkuar pezullimin e punimeve në këto dy objekte, pasi ka përfunduar afati i lejes së ndërtimit dhe mungonte oponenca teknike, ndërkohë që në këtë ndërtesë vazhdonin ende punimet për të përfunduar kompleksin. 72-vjeçari Fratari, është vënë nën akuzë për "Ndërtim pa leje".



Pallati i Fratarit në Selitë të Vjetër, që sipas policisë është pa leje

**REAGIMI**

**Familja Fratari: Nuk është arrestim politik**



Aranit Roshi

Familja Fratari dhe avokati i të ndaluarit Hajredin Fratari, Aranit Roshi kanë reaguar pas arrestimit të biznesmenit dhe daljes publike të PD. Familjarët deklarojnë se, kjo nuk është një çështje politike. Ata pretendojnë se të gjitha dokumentet e ndërtimit në Selitën e Vjetër janë të rregullt dhe gjithçka do të sqarohet. "Nuk është një ndalim, arrestim me prapavijë politike por është një procedurë që pas shikimit të dokumentacionit të ndërtimeve do të sqarohet", ka thënë mbremjen e djeshme avokati Roshi thotë se janë të gjithë të rregullta. "Është një procedurë ligjore, dokumentacioni është në rregull, leja dhe leja e shtyrjes janë të gjitha të rregullta", thotë avokati Aranit Roshi.

**Reagimet**

## PD e PS përplasen për prishjet e ndërtimeve pa leje e ndalimet

**ARRESTIMI I FRATARIT**

Hetimi ndaj biznesmenit Hajredin Fratari kishte kohë që po vazhonte. Burime nga policia kanë thënë mbremjen e djeshme për Shqiptarja.com se, "Hajredin Fratari, 72 vjeç, ishte nën hetim prej 6 muajsh, pasi ishin siguruar prova në lidhje me aktivitetin e të ndaluarit". Ndërkaq arrestimi i tij është bërë mesditën e djeshme pikërisht në pallatin që ai po ndërtonte pa leje në Selitën e Vjetër. Kanë qenë efektivët e Komisariatit numër 1, ata që kanë bërë edhe ndalimin e biznesmenit. Sipas policisë Fratari po ndërtonte një kompleks pallatesh pa leje në zonën e Selitës së Vjetër, duke shkelur hapur rregullat e ndërtimit urbanistik. Arrestimi i tij është realizuar nga efektivët e

Partia Demokratike dhe ajo Socialiste janë përplasur me deklaratatë kundërta pas arrestimit të biznesmenit Hajredin Fratari. Ishin demokratët fillimisht me anë të Flamur Nokës që e kanë cilësuar si një shenjë hakmarrje arrestimin e biznesmenit të ndërtimit, Hajredin Fratari. Deklarata e Nokës është bërë pranë komisariatit Nr 1 në Tiranë, ku kishin shkuar për të takuar biznesmenin e arrestuar nga efektivët e këtij komisariatit për ndërtim pa leje. Sipas Nokës arrestimi i Fratarit është një shenjë e pastër hakmarrje e Kryemi-

nistrit, pasi ai ka akuzuar Ramën se i ka kërkuar 1 milionë dollarë. "Hakmarrje e verbër, ajo që është më e dhimbshme është se nuk e lejojnë që të takohet me avokatin apo t'i japin ilaet. Kemi një shtet policor. Dita e sotme tregojnë se Rama vijon ditën e gjuetisë së shtrigave, ditët e premtë." - theksoj Noka. Më pas reagoi edhe PS. Me një komunikatë për shtyp, selia rozë hodhi poshtë akuzat e PD se aksioni i INUK po bëhet me veprime selektive duke mos prishur objekte që kanë lidhje me deputetët e majtë, dhe konkretisht me kryeministrin

Edi Rama. Sipas deputetëve të PS, objektet e denoncuar nga opozita, janë legalizuar në mënyrë kriminale nga vetë PD në kohën kur ishte në qeveri, dhe se prishja e tyre do të kishte një kosto të papërbalueshme për momentin. Gjithashtu i rikujtohet kreu të Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha se është detyrë e këtij institucioni që ai drejton që të shembë këto objekte, por se sipas tyre kjo nuk ndodh për shkak se Basha ka lënë pas dore Tiranën duke u marrë më shumë me Partinë Demokratike, në cilësinë e tij si kryetar.

**VIDEO/ BIZNESMENI FRATARI PËR KOMPLEKS PA LEJE**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

# Lulzim Basha i kërkon ndihmë kreut të KE për marrëveshje me PS

## Takimi në Bruksel, kreu i PD-së: E informova mirë presidentin Juncker mbi situatën në Shqipëri



Kreu i PD-së Basha dhe kryetari i Komisionit Evropian, Juncker

ERVIN KOÇI  
TIRANE

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha i kërkon ndihmë kryetarit të Komisionit Evropian, Juncker për të arritur marrëveshjen politike në Shqipëri. Gjatë një takimi të zhvilluar dje në Bruksel, kryetarët e Partive Popullore Evropiane kanë diskutuar lidhur me mandatin e ri të Këshillit të Evropës ku në fjalën e tij, kreu i PD-së ka theksuar edhe rëndësinë e një marrëveshjeje politike në Shqipëri. Duke qenë se PD nuk pranon asnjë diskutim pa ndërhyrjen

e ndërkombëtarëve, ai i ka kërkuar ndihmë dje presidentit të Komisionit Evropian si titullar më i lartë në KE, organ ky që mbikëqyr edhe procesin integruar të Shqipërisë. "Është një ekip shumë premtues, pa dyshim, nën lidhshmëri dhe kryetarit të Komisionit, presidentit Juncker, me të cilin pata rastin të takohem e të bisedoj, ta uroj për përgjegjësitë e reja që ka marrë. E njoha me zhvillimet e fundit në Shqipëri, për të cilat është i mirëinformuar dhe mendoj se si presidentit Juncker, ashtu edhe kërret e disa qeverive dhe partive simotra në këtë samit, fokusi tek Shqipëria dhe tek Evropa Juglindore nuk do u mungojë. Është e qartë se rreshtqija nga standardet demokratike

është një alarm i madh edhe për Komisionin e ri Evropian dhe në këtë kuadër mendoj se angazhimi i komisionit të ri, i komisionerit Hann, i kryekomisionerit, presidentit Juncker, i Parlamentit Evropian dhe përfaqësuesve të PPE në të gjitha këto struktura do të jetë i domosdoshëm dhe frutdhënës për t'i dhënë fund praktikës së zhbërjes së standardeve demokratike në Shqipëri, si një parakusht për të garantuar ecjen përpara të Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian", theksoi zoti Basha.


### DIALOGU

Që prej dy javësh dy partitë më të mëdha në vend kanë intensifikuar qëndrimet për të arritur një

marrëveshje politike në mënyrë që jeta parlamentare të rikthehet normalitetit. Në qëndrimin e tij, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka theksuar gjithmonë se kjo marrëveshje mund të arrihet vetëm me ndërmjetësim të ndërkombëtarëve si garanci që kjo marrëveshje të vijoj dhe të mos prishet. Mazhoranca nga krahu i saj është shprehur pro kësaj nisme që marrëveshja të bëhet me ndërmjetësim të ndërkombëtarëve ku krahas kësaj, ka miratuar edhe kërkesa e opozitës për tu rikthyer në Kuvend. Por kjo gjë mesa duket nuk e ka bindur PD-në e cila vijon takimet me përfaqësuesit e shteteve të huaja për të ndërmjetësuar një marrëveshje politike.

### Drejtesia

## Të hënën Naço seancë dëgjimore tek "Ligjet"



■ Në prag të tryezës së radhës për reformën në Drejtësi, Komisioni i Ligjeve do të zhvillojë të hënën një seancë dëgjimore me Ministrin e Drejtësisë Nasip Naço për rekomandimet e dhëna në progres raportin e Bashkimit Evropian. Në axhendën e punimeve parlamentare është parashikuar se në Komisionin e Ligjeve të zhvillohen dy seanca dëgjimore për progres raportin e Komisionit Evropian për integrimin e vendit në BE. "Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Në rend të ditës: Seance dëgjimore për Progres Raportin e KE 2014, me: 1. Ministrin e Drejtësisë 2. Ministrin për Inovacionin dhe Administratën Publike", - thuhet në axhendën e punimeve të Komisionit të Ligjeve. Kjo seancë dëgjimore me ministrin e Drejtësisë, Nasip Naço dhe Ministrin Milena Harito bëhet vetëm katër ditë përpara se sa të zhvillohet reforma e radhës për reformën në drejtësi ku të gjitha rekomandimet e dhëna nga KE do të jenë pjesë e këtyre ndryshimeve ligjore. Krahas kësaj, edhe Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike do të jetë sërish pjesë e këtij diskutimi pasi edhe ligji për nëpunësin civil ka më shumë se 8 muaj që ka mbetur pezull në Kuvend pa u shqyrtuar.

# Përzgjidhen 4 emrat për AMA, pas dy seancash votohet kryetari Peza thirrje opozitës për të thyer bojkotin për të hequr dy emra



Gentian Sala, Gentian Skënderaj, Anila Basha dhe Bers Hado, janë katër kandidatët e përzgjedhur dje nga Komisioni Parlamentar i Medias për postin e kryetarit të ri të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA). Në fillim mbledhjes, nënkryetari i komisionit, Alfred Peza, i bëri sërish thirrje opozitës që të vijë dhe të ushtrojë të drejtën e saj ligjore për të eliminuar dy nga katër kandidatët e përzgjedhur. Anëtarët e komisionit, gjatë një mbledhje me dyer të mbyllura, me shumicë votash përzgjedhën katër anëtarët e mësipërm, ndërsa tre kandidatët e skualifikuar nga gara ishin Zylyftar Bregu (gazetar), Raif Gorana (ekonomist) dhe En Muçi (ekonomist), të cilët morën më pak vota. Në mbledhjen e radhës të komisionit, katër kandidatët fitues do të ftohen në një seancë dëgjimore, ku nënkryetari Peza ftoi të gjithë deputetët e parlamentit që të jenë të pranishëm, duke siguruar në këtë mënyrë transparencë të plotë. Më pas, do të jetë seanca e ardhshme plenare, e cila do të votojë për kryetarin e ri të AMA-s.

drejtë që të bëjë përzgjedhimin e dy kandidatëve nga katër që ka përzgjedhur mazhoranca, më pas dy kandidatët do të shkojnë në seancë plenare për tu votuar. Votimi bëhet i fshehtë në mënyrë që vota të mos lexohet. Por nëse opozita nuk bënë përzgjedhimin e dy kandidatëve, atëherë që të katër emrat do të kalojnë për votim në seancë plenare. Kësaj,

mazhoranca do të kalojë procedurën e të drejtës së opozitës për të skualifikuar dy emra pasi që të katër kandidatët do të shkojnë për votim në seancë. Por kjo gjë do të nis sërish akuzat e Partisë Demokratike për AMA-n e cila që në fillimin e këtij procesi rreth një vit më parë ka akuzuar mazhorancën se kërkon që të kap këtë institucion.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMEVE

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit:

**"Blerje 50.000 (±10%) litra Blu Diesel dhe 34.000 (±10%) litra benzinë pa plumb 95 oktan, për nevojat e Bankës së Shqipërisë në Tiranë"**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i Hapur Kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 16.000.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: ish-Hotel Dajti, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 042235576, çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 2.000 lekësh, në Sektorin e Financës të Bankës së Shqipërisë, që ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla B.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 21 Nëntor 2014, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Sheshi "Avni Rustemi", Nr 24, Tiranë. Tel: +355-4-241 9301/02/03, +355-4-241 9409/10/11,

Faks: +355-4-241 9408; e-mail: public@bankofalbania.org; www.bankofalbania.org



**Barnat**

Kryeministri ka shprehur përgëzimet e tij ndaj Ministrisë ndërsa ka pohuar se këtë vit në listën e barnave të rimbursueshme janë përfshirë katër ilaçe për kujdesin paliativ të cilat janë 100% të rimbursueshme

**Apel për t'u bashkuar dhe mediat e tjera**

**A1 Report: Vazhdojmë fushatën falas edhe për 1 vit**

— Kronikat televizive tek A1Report dhe shkrimet tek "Shqiptarja.com" gjatë muajit tetor kanë qenë të përditshme, duke u bërë thirrje grave shqiptare të ndërgjegjësohen dhe të kryejnë ekzaminimet të kancerit të gjirit. Dhe gjithë kjo fushatë sensibilizimi një mujore ka qenë falas. "Ne si grup mediatik A1Report dhe Shqiptarja.com që vitin e kaluar, vumë në dispozicion falas hapësirat tona dhe organizojmë veprimtari kreative

për fushata sensibilizimi kundër kancerit të gjirit, duke organizuar edhe dy Konferenca Ndërkombëtare. Të flasësh për parandalimin e kancerit të gjirit vetëm në muajin tetor nuk mjafton, kështu kemi vendosur të shpallim jo më vetëm një muaj, por një vit të tërë dedikuar kësaj sëmundje. Ne do të vazhdojmë të transmetojmë spot sensibilizues falas dhe ftojme të gjithë mediat të bashkohen me ne në këtë lëvizje që është kombëtare

dhe jo personale. Informacioni për sëmundjen e kancerit të gjirit është shumë i rëndësishëm, pasi rrit ndërgjegjësimin për të kryer kontrollin dhe vizitat. Sensibilizimi për këtë sëmundje është me rëndësi, në mënyrë që të bëhet në kohë diagnostikimi i kësaj sëmundje dhe kurimi i saj", tha gazetari Bollino, ndërsa u ka bërë apel edhe mediave të tjera ti bashkohen kësaj nisme e cila ka për qëllim shpëtimin e jetëve.



**Ekzaminimet**

Gjatë muajit tetor rezultoi se numri i ekzaminimeve u rrit me 85% sa gjithë ekzaminimet të kryera përgjatë gjithë vitit në institucionet publike. Ndërkohe lista e pritjes në 8 qendrat stacionare është e gjatë për të kryer depistim

# Beqaj: Ekzaminime falas pas tetorit për gratë e regjistruara

A1Report dhe Shqiptarja.com zhvillojnë Konferencën Ndërkombëtare "Bashkë Kundër Kancerit të Gjirit"



Konferenca për luftën kundër kancerit të gjirit

**UNFPA**

**"Vëmendje edhe grave në zonat rurale"**

— Përfaqësuesja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Zineb Touimi-Benjelloun, tha se fokusi i veçantë duhet t'i kushtohet grave në zonat rurale, që s'kanë mundësi të kenë këtë shërbim. "Gratë po marrin mesazhet dhe informacionet për testet dhe shërbimet, për të kapur tumorët në faza të hershme, por ka ende shumë punë për përmirësim. Gjithashtu ka gra në zonat rurale që kanë vështirë për këtë akses. Shqipëria ka potencial në shërbimet e depistimit dhe i ka kushtuar vëmendje parandalimit. Edukimi i grave do të ishte shumë natyror dhe do i lejonte sistemit të shëndetësisë, për t'u shpërndarë në gjithë vendit, dhe për të shpëtuar jetë" tha Zineb Touimi-Benjelloun. Ndërkohe që ka garantuar për një bashkëpunim të mëtejshëm me Ministrinë e Shëndetësisë.

**SONILA ISAKU  
TIRANE**

**T**ë gjitha gratë të cilat janë regjistruar në listat e pritjes për kryerjen e mamografisë do ta përfitojnë shërbimin falas edhe pas muajit tetor. Ky fakt është bërë i ditur nga vetë Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj gjatë Konferencës Ndërkombëtare "Së bashku Kundër Kancerit të Gjirit. Kreu i shëndetësisë ka bërë me dije se numri i personave të regjistruar deri më tani në të gjitha qendrat stacionare të mamografisë është shumë i madh. "Sot që ne flasim rezultun se numri i grave që kanë regjistruar emrin për këtë ekzaminim në këtë muaj është jashtëzakonisht i madh. Dua ti siguroj ato që edhe pse kemi thënë që ekzaminimi do jetë pa pagesë vetëm në muajin tetor, listë e pritjes që do të mbyllet në mbremjen e 31 tetorit, do të vazhdojë të marrë këtë ekzaminim falas edhe pas kësaj date" ka pohuar Beqaj. Sipas tij, numri i ekzaminimeve të kryera në këtë muaj është sa 85% e atyre të kryera gjatë gjithë vitit. "Edhe z.Carlo Bollino e shpjegoi se numri i grave që kanë ardhur për të kërkuar një ekzaminim mamografik deri në datën 20, është sa 9 muajt e parë, që do të thotë kemi nevojë për më shumë informacion, më shumë promovim, por kemi nevojë edhe për të thyer disa barrierat që ekzistojnë në vend." ka pohuar Beqaj. Sa i përket investimeve të kryera në shëndetësi, kryeministri Rama pohoi se problemi i kancerit të gjirit

**VIDEO/ RAMA: GRATE, TË NDRËGJËGËSOHEN PËR KONTROLLE**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP TË A1REPORT që shkarkohet falas

është parë në kënd 180 gradë. "Këtë muaj besoj se Ministria e Shëndetësisë meriton të përgëzohet për faktin se e ka parë problemin në 180 gradë, besoj dhe për fatin se ka ardhur në këtë moment me disa hapa të kryer. Në listën e barnave të rimbursueshme ku janë përfshirë katër barna për kujdesin e gjithanshëm, paliativ, që janë barna të rimbursueshme

100%. Janë 8 mamografë stacionare janë jashtë Tiranës. Ka një ritëm ekzaminimesh, e përmendi Carlo Bollino, që nga 1 deri në 15 Tetor është 85% e ekzaminimeve që janë bërë nga 1. Janari deri në 30 Shtator. Sigurisht që, çdo grua që nuk ka shkuar akoma drejt një mundësie ekzaminimi apo nuk është ndeshur me një mundësi të tillë" nënvizoi

Rama. Një mesazh të rëndësishëm përcolli edhe moderatori i kësaj konference, gazetari Carlo Bollino vuri theksin në rëndësinë e informimit lidhur me këtë sëmundje, në mënyrë që shoqëria të ndërgjegjësohet për të kryer vazhdimisht kontrollin dhe vizitat. "Vitin e kaluar ne kemi organizuar një konferencë e cila pati një impakt të gjerë. Këtë vit sipas

informacioneve që kemi marrë sipas Ministrisë së Shëndetësisë numri i grave që kanë kërkuar një mamografi është shumëfishuar 8 herë vetëm për efekt të komunikimit të përqendruar në një muaj" ka pohuar gazetari Carlo Bollino. Gjatë kësaj konference mjekë italianë e shqiptarë shpалosen të rejtat më të fundit të mjekësisë për kurimin e kancerit të gjirit.

**Mjekët italianë pjesëmarrës në konferencë**

## Luini: Vetëkontrolli hapi i parë Gatti: Si munda kancerin

— Mjekët dhe ekspertët italianë të ardhur në Shqipëri enkas për Konferencën Kundër Kancerit të Gjirit kanë treguar eksperiencat e tyre por edhe hapat e parë që duhet të ndjekë një grua për të kryer vetëekzaminim. Alberto Luini, një nga senologët më me emër në Evropë ka bërë apel femrave të ekzaminohet gjinjtë e tyre duke ndjekur edhe 3 mënyrat e duhura. "Ekzaminimi i kancerit të gjirit është shumë i rëndësishëm. Ekografia është një mënyrë ekzaminimi shumë e rëndësishme për të gjetur tek gratë e reja gjendrë beninj por në raste të shumta mund të gjendet edhe një gjendër tumorale. Kemi edhe rezonancën magnetike ndërkohë që mamografia është një tjetër ekzaminim për të cilin keni dëgjuar të gjithë dhe që mund të bëhet pas moshës 40 vjeç. Më pas përdorim një mënyrë edhe me të saktë të

ekzaminimit që quhet Stomosintezë që mundëson që të shihet se çfarë është brenda gjendrës si dhe përfitohen imazhe shtresë pas shtresë për të parë se deri në cilën pikë është gjëndra." tha Luini. Nga ana tjetër doktoresha italiane Giovanna Gatti ka ndarë eksperiencën e saj, pasi është diagnostikuar me kancer në qafën e mitrës 6 vite më parë, dhe u ka bërë apel të gjitha grave që të mos ngurojnë të kryejnë kontrollin. "Unë i mbijetova kancerit në qafën e mitrës, dhe falë kontrollit që bëra tashmë kam 6 vite më shumë jetë. Them se të gjitha gratë nuk duhet të kenë frikë të bëjnë vizitën dhe kontrollin. Kjo do të mbrojtë jetën e tyre. Aktiviteti fizik ul rezikun e kancerit të gjirit.", u shpreh doktoreshë Gatti ndërsa ndanë me kolegët e tyre të rejtat e fundit të teknologjisë dhe trajtimit të sëmundjeve cancerogjene.



### Projektet

## Gaiani: T'i japim rëndësi parandalimit të kancerit

— Ndërgjegjësimi ndaj sëmundjeve kancerogjene duhet të rritet maksimalisht ndërkohë që mbështetja nga vendi fqinj Itali do të jetë gjithmonë. Ky është premtimi dhe mesazhi që ka dhënë Ambasadori i Italisë në Shqipëri Massimo Gaiani dje gjatë konferencës “Së Bashku Kunder Kancerit të Gjirit”. Duke u ndalur tek rëndësia e rritjes së ndërgjegjësimit ndaj kësaj sëmundje, ambasadori Gaiani theksoi se duhet t'i jepet rëndësi projekteve të parandalimit të kancerit. “Italia dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë pranë njëra-tjetrës edhe në këtë drejtim. Padyshim që do t'i japim rëndësinë e duhur edhe projekteve të parandalimit të këtyre sëmundjeve”, u shpreh ambasadori Gaiani.



### Historitë

Gjatë fjalës së tij në Konferencën Ndërkombëtare Kundër Kancerit të Gjirit kryeministri Edi Rama ka sjellë në vëmendje të pjesëmarrësve dëshmitë rrëqethëse të personave të prekur nga kjo sëmundje, histori të njohura nga ai personalisht.

### Aktiviteti

## Konferenca mbi 400 pjesëmarrës e shumë mbështetës

— Konferenca e djeshme Kundër kancerit të Gjirit ka regjistruar mbi 400 të pranishëm, ku mes tyre ishin edhe ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli, ajo e Turizmit Eg-lantina Gjermeni, e Arsimit Lindita Nikolla, ministria e Kulturës Mirela Kubaro, deputetet Arta Dade, Val-entina Leskaj, drejtoresha e QSUT Ogerta Manastirliu, ambasadorë të akredituar në vendin tonë, politikanë e gazetarë. Por një

tjetër sukses konferencës së or-ganizuar nga televizioni A1Report dhe gazeta “Shqiptarja.com” ishte edhe numri i madh i mbështetësve të saj. Kështu, aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e UNFPA që ka mbuluar drejtpërdrejt një pjesë të organizimit dhe në bashkëpunim me Petrolifera Italo-Albanese, Spitalin Amerikan dhe Pro-Farma të cilat kanë mbuluar pjesën tjetër të shpenzimeve.



# ‘Si vendosëm të projektojmë gjinjtë mbi Kryeministri’

## Rama: I kënaqur që IEO bashkëpunon me Shqipërinë

SONILA ISAKU  
TIRANE

**Q**elizat kancerogjene duhet të luftohen e buzëqeshje, këngë, kërcime dhe të qeshura. Ky ka qenë mesazhi që u ka përcjellë kryeministri Edi Rama të gjitha pacientëve dhe grave shqiptare. Kreu i qeverisë përmes dësh-mive rrëqethëse të personave të prekur nga kjo sëmundje, ka treguar historitë e letrave që ia lexon nga qytetare të ndryshme. “Mos e harro - i thosha vetes, - qelizat kanceroze e urrejnjë të qeshurën, i urrejnjë shakatë, këngët dhe kërcimet. Kanceri ikën kur ka të tilla. Qelizave të mallkuara u pëlqen trishtimi, u pëlqen depresioni, u pëlqen hidhërimi dhe u pëlqen shumë

frika. Kurse gëzimi i përzë.” Këto fjalë i shkruan në një letër një grua e diagnostikuar me kancer në gj, e cila tregonte eks-periencën e vetë dhe tregonte sesi rruga për ta fituar këtë betejë nuk kalon nga shmangia, nga fshheja apo nga dorëzimi përpara kësaj të vërtetë të re në trupin e gruas, por kalon nga e kundërta e saj” ka pohuar kreu i qeverisë. Këtu kreu i qeverisë është ndalur për të treguar edhe vendimin që u mor për të projektuar bustet e zhvshura të femrave mbi kryeministri. Sipas tij, letrat që i drejtohen atij nga pacientet e prekura kanë qenë shtysa kryesore që të veshin fasadën e kryeministrit me këto imazhe. “Ajo letër ishte edhe shtysa kryesore e nismës që ndërmorëm bashkë me Carlon për t’ia dorëzuar gjinjtë të grave fasadën e Kry-



eministrit dhe për të hapur një debat për trupin e gruas. Asnjë shoqëri, faktikisht, nuk është aq e zhvilluar sa duhet, nuk është aq demokratike sa duhet nëse nuk arrin dot të debattoj lirshëm për këtë. Për fasadën e Kryeministrit, të pushtuar nga trupat e grave,

pati shumë komente kontro-verse, imagjoni nëse ne aty do të kishim vënë gjokse burrash dhe trupa burrash, askush s’do ishte marrë fare. Ose, mak-simalisht, do kthenim kokën nga ana tjetër dhe do thoshin ç’është kjo shije pa shije. Nuk do të kishin faj, në fakt, por thjeshtë për të kuptuar që në këtë rast nuk do të ishte diskri-minuese po të kthenim kokën nga ana tjetër, përballë trupave të burrave dhe gjokseve të bur-rave, por është diskriminues fakti që nuk e kthejnë kokën nga ana tjetër, përkundrazi tregojnë me gisht dhe bëjnë gjithfarë komentesh vulgare kur vjen puna për trupin e gruas. Komente vulgare konsideroj edhe ato që medemek e marrin në mbrojtje trupin e gruas si diçka e patregueshme dhe e pashfaqshme” ka thek-suar Rama ndërsa përmend një tjetër letër ku një grua e prekur nga kanceri dërgon letrat tek shoqet e veta dhe në fund ve buzë të gjurmëve. Po kështu të njëjtën gjë kërkon edhe kur ti kthehet letra, pasi ato buzë janë shenjë e triumfit mbi vdekjen. E duke bërë apel mbi këtë sëmundje Rama ka theksuar se tashmë Instituti Evropian i Onkolog-jisë do të nisë bashkëpunimin me institucionet shqiptare. “Studimet revolucionare të Umberto Veronesit në paran-dalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e kancerit të gjirit janë absolutisht një kontribut i madh për njerëzimin. Tan-imë do të jenë pjesë edhe e njohjes dhe e përpjekjes sonë, në Tiranë, përmes institucion-ëve tona, në betejën me kancer-in e gjirit dhe në mbështetje të çdo gruaje dhe vajze që gjendet përballë kësaj sfide. Kjo është një nismë, meritën për të cilën e ka Carlo Bollino, se pavarë-sisht se e takuam edhe ne të tjerët profesorin, ai besimin e mori nga Carlo, jo nga ne. Unë

### ALBAN YLLI

## Rriten rastet e reja me kancer gjiri

— Specialistët e Institutit të Shëndetit Publik kanë treguar se gjatë viteve të fundit janë rritur rastet e pacientëve të prekura nga kanceri i gjirit dhe ai i mitrës. Specialisti Alban Ylli ka theksoi rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të së-mundjes në mënyrë që trajtimi të jetë më efikas. “Kanceri i gjir-it në Shqipëri është rritur, referuar edhe shifrave të INSTAT. Kjo e ndikuar nga ndryshimi i profilit demografik të ven-dit. Është një kancer që mund të haset në moshë relativisht të reja. Shpresojmë të kemi arritur në pikun e kancerit të gjirit, pra së mos ketë më rritje të ras-teve” ka pohuar Ylli, ndërsa kërkon më shumë ndërgjegjë-sim për gratë.

**Kimioterapia**  
Duke filluar nga pranvera e 2015, shërbimi i kimioterapisë do ofrohet edhe në 5 spitale të tjera në Shqipëri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMEVE



## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit:

**“Ngritja e sistemeve IT për mbështetjen e proceseve në menaxhimin e informacionit dokumentar dhe fjalëkalimeve dhe upgrade i San Storage & Backup”.**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i Hapur Kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 75.387.000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: ish-Hotel Dajti, Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Tel. 042235576, çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 2.000 lekësh, në Sektorin e Financës të Bankës së Shqipërisë, që ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla B.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 19 Nëntor 2014, ora 11.00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Sheshi “Avni Rustemi”, Nr 24, Tiranë. Tel: +355-4-241 9301/02/03, +355-4-241 9409/10/11,

Faks: +355-4-241 9408;

e-mail: public@bankofalbania.org;

www.bankofalbania.org

jam shumë mirënjohës që sot Carlo erdhi njësoj si vitin e kaluar, si organizator i kësaj ngjarjeje, por me këtë vlerë të madhe të shtuar” ka pohuar Rama, ndërsa nuk ka har-ruar të drejtojë mesazhe ndaj grave për të kryer depistime të herëpashershme.

# AKKP: 8.343 dosje të ish-pronarëve ende pa zgjidhje

Drejtoresha Qato: Për pak ditë, dorëzojmë në qeveri fondin e tokës për kompensimin fizik



**N**donëse kashumë vjet janë krijuar institucione për kthimin dhe kompensimin e ish-pronarëve, ende presin radhën për zgjidhje 8.343 dosje. Kjo është shifra e saktë e tyre, sipas drejtoreshës së Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, ndërkohë që ishte raportuar më parë se ato ishin 7.400. Sipas Sonila Qatos, procesi po vijon me hapa jashtëzakonisht të ngadaltë dhe ende shteti ndodhet në proces kompensimi të vendimeve për kompensim deri në vitin 1995, shumë pak kjo, në raport me vendimmarrjen përkatëse në 20 vjet.

Ndërkohë, qeveria shqiptare edhe një herë deklarohet se synon t'i japë zgjidhje përfundimtare çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri. Për këtë, ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

nisën dje procesin e konsultimit me grupet e interesit për hartimin e reformës ligjore dhe institucionale të AKKP-së. Projekti synon gjetjen e një skeme të shpejtë kompensimi, edhe nisur nga fakti se Gjykata e Strasburgut e ka kushtëzuar këtë në një vendim pilot të pak muajve më parë. Skema e re pritet të mbështetet më shumë në kompensimin fizik sesa në atë monetar.

Në këtë kuadër, brenda tetorit AKKP do të dërgojë për miratim në qeveri fondin fizik të pronës tokë bujqësore, në masën 25 mijë hektarë, që do t'u jepej ish-pronarëve, duke lehtësuar kështu futurën e kompensimit financiar të tyre. Ndërkohë, po vijon puna edhe për inventarizimin e pronave të tjera shtetërore, të cilat do të vihen në dispozicion të fondit fizik për kompensimin.

Ndërkohë, zv.ministri i Drejtësisë Ildir Peçi shtoi se detyra tjetër është hartimi dhe dorëzimi i futurës përfundimtare financiare, të shumës që duhet të paguajë shteti për ish-pronarët me para në dorë. "Vetëm pasi të kemi arritur të nxjerrim këtë faturë financiare, e cila ka munguar për 23 vite me radhë, do të mund të nisim hartimin e formulës së kthimit dhe kompensimit të pronave", deklaroi ai.

Qato theksoi se deri tani është bërë i mundur skanimi i të gjitha vendimeve të arkivuara në AKKP. Po ashtu, tha ajo, u realizua regjistri themelor i vendimmarrjes në kthimin dhe kompensimin e pronave në vitet 1993-2014. Sipas saj, ky regjistër u përfundua dhe u publikua on-line, ndërsa ka nisur edhe konsultimi publik i këtij regjistri me qëllim plotësimin dhe saktësimin e informacionit. Drejtoresha e AKKP theksoi se në muajin tetor të vitit 2013, ky institucion, i ngarkuar me ligj për të trajtuar çështjet e kthimit dhe kompensimit të pronave, ndjeu se nuk ishte në gjendje të prodhonte asnjë

të dhënë zyrtare për procesin dhe vendimmarrjet përkatëse në këtë fushë. Strategjia Sektoriale për pronat 2012 - 2020 kishte mbetur vetëm në letër dhe e paimplementuar, përpos faktit se, më shumë se strategji, ajo pasqyrore problematikat përkatëse, pa parashikuar zgjidhje dhe detyra konkrete për qeverinë dhe agjencitë e ngarkuara për çështjet e pronësisë. Në AKKP identifikuam një arkiv të rremujshme dokumentash

**Fondi**  
Agjencia ka punuar për identifikimin e pronave shtetërore që mund të vihen në dispozicion të fondit fizik të ish-pronarëve. Siç është vendosur, ai do të përbëhet nga 25 mijë hektarë

prone, ku presupozohej të kishte ushtruar aktivitet ky institucion, tha ajo.

## LAJME shkurt

### Debitorët e energjisë, në sportele për faturat

— Dy ditë e fundit abonentët familjare kanë filluar të dynden në sportele për të paguar faturat e prapambetura të energjisë elektrike. Në Elbasan ka pasur rritje të përqindjes së arketimeve, ndërkohë që edhe në Durrës njerëzit mbajnë radhë për të paguar faturat për energjinë e konsumuar. Tri ditë më parë, kryeministri Edi Rama lëshoi ultimatumin, duke lënë pesë ditë afat që vjedhësit t'i kthehen rrugës së ligjit dhe të shlyejnë detyrimet për energjinë elektrike të konsumuar.



### Gjikhuri në Norvegji për investime në energjetikë

— Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjikhuri zhvilloi një vizitë dyditore në Norvegji ku u prit nga ministri i Naftës dhe Energjisë Tord Lien. Në kuadrin e fillimit të procedurave të licencimit të blloqeve të reja të naftës dhe gazit në Shqipëri, ministri norvegjez nënvizoi rëndësinë e kryerjes së studimit gjeo-sizmik të zonave të pa-eksploriuara, për sigurimin e të dhënave të nevojshme, që do të çonin në një shfrytëzim dhe prodhim efektiv të rezervave të naftës dhe gazit.

**TETRA TECH ARD**

**Co-PLAN**

**MUNICIPAL MANAGEMENT SPECIALIST POSITION**

**USAID PLANNING and LOCAL GOVERNANCE PROJECT (PLGP), ALBANIA**  
The USAID Planning and Local Governance Project in Albania (PLGP) has an immediate opening for a full-time Municipal Management Specialist. The goal of PLGP is to provide technical assistance and training to the Government of Albania (GoA) and to Albanian local government institutions - to help the GoA and local governments successfully implement decentralization legislation, policies and reforms. USAID PLGP is a five year project started in January 2012 and is implemented by Tetra Tech in cooperation with two local subcontractors, Co-Plan and Valu-Add Management Services.

The position requires an individual who is highly technically capable and experienced in provision of training and technical assistance to local governments in areas of municipal services, capital investment plans, local taxes and fees, own source revenues, management of municipal assets, Public Private Partnerships and alternative financing. This is intended to be a two-year position with a start date of November 2014.

- Municipal Management Specialist - Position Requirements**
- Bachelor's Degree in Public Administration, Social Sciences, Economy or related field is required;
  - Minimum five (5) years of work experience in local governance related areas;
  - Ability to engage and coordinate with project stakeholders at both national and local level;
  - Ability to produce high quality reports in both English and Albanian language;
  - Fluent knowledge of spoken and written English and Albanian required;
  - Ability to work under pressure and cope with deadlines;
  - Must be able to work in a multi-cultural environment with sensitivity and respect for diversity;
  - Must be capable of working both individually and as part of a team;
  - Good written and spoken communications skills; ability to write in a clear and concise manner and to provide detailed explanations orally;
  - Excellent interpersonal skills, including patience, diplomacy, willingness to listen and respect for colleagues.

**To Apply:**  
Please e-mail full, current CV in reverse chronological format and cover letter to [PLGPAmbianirecruitment@yahoo.com](mailto:PLGPAmbianirecruitment@yahoo.com)

Please refer to the **Municipal Management Specialist Position** in the subject line. Applications must be received by **close of business on November 7<sup>th</sup>, 2014** to be considered. Only candidates meeting the qualifications detailed above will be contacted. No phone calls, please.

Tetra Tech is committed to diversity and gender equality in all of its operations in the U.S and overseas. We strive to reflect these goals in our global mission and in our workplace. We encourage applications from women and underrepresented ethnic, racial and cultural groups. Tetra Tech is proud to be an Affirmative Action/ Equal Opportunity Employer.

**Arbitrazhi**

## Anulimi i koncesionit, Rapiscan kërkon 360 mln euro

— Pas vendimit të qeverisë për anulimin e koncesionit të skanimit të konteinerëve, kompania Rapiscan e ka çuar çështjen në gjyq ndërkombëtar. Në një njoftim zyrtar Avokatura e Shtetit fin të gjithë subjektet e interesuar të aplikojnë për pjesëmarrje në procesin e dhënies së asistencës dhe përfundimit të Ministrisë dhe Financave/Drejtorisë e Përgjithshme të Doganave në zhvillimin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes me shoqërinë S2 Albania Sh.p.k. dhe Rapiscan Systems, bazuar në kontratën datë 10 prill 2013 "Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit". Vlerësohen më së shumti studiot ligjore që kanë eksperiencë në arbitrazhin ndërkombëtar. Kompania do të kërkojë rreth 360 milionë euro dëmshpërblim për ndërprerje të kontratës.

**Aksioni**



**ARTAN CENA**  
TIRANE

**T**re të rinj janë vënë në pranga ndërsa u është sekuestruar edhe 1.5 kilogramë heroinë e pastër e cila dyshohet se e ka origjinën nga Turqia dhe që vinte në vendin tonë me rrugë tokësore. Aksioni është zhvilluar pasditën e djeshme në Tiranë në zonën e rrugës së Durrësit. Operacioni "Trafik 2014" kishte nisur që në mua-

Policia e Tiranës ka përfunduar dje operacionin policor të koduar "Trafik 2014"


# Trafiku i heroinës nga Turqia në Tiranë, tre të arrestuar

## Arrestimet u kryen gjatë shkëmbimit të drogës te rr. e Durrësit

jin gusht dhe ditën e djeshme policia ka mundur të vejë në pranga 3 persona të përfshirë në shitjen e lëndës narkotike. Të arrestuarit janë: Lulzim Fregjaj, 56 vjeç, Vilfred Cenolli 49 vjeç dhe Klodian Spahi, 36 vjeç, bashkëpunëtor në trafik. Këta të fundit ishin në ndjekje nga policia dhe janë vënë në pranga në momentin që ishin duke shtitur lëndën narkotike, për një shumë të konsiderueshme në euro.



Vilfred Cenolli



Lulzim Fregjaj



Klodian Spahi

hur në rrugën e "Durrësit" në Tiranë, përgjatë momenteve të shkëmbimit të lëndës narkotike Heroinë si dhe një shumë të konsiderueshme parash.

**HETIMET PËR TRAFIKUN**

Policia bën të ditur se nga hetimet e kryera deri më tani, është arritur të goditet në kohë një linjë trafiku, Turqi - Shqipëri, duke sekuestruar sasinë prej 1.5 kg lëndë e dyshuar Heroinë e pastër, e cila ishte e ndarë në disa pako. Gjithashtu mësohet se hetimi ka nisur në muajin gusht të këtij viti, duke bashkëpunuar ngushtësisht me Prokurorinë për Krimet e Rënda. Ky hetim, si dhe të vijoj për të identifikuar të tjerë persona të përfshirë në këtë trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

**AKSIONI I POLICISË**

Pasditja e djeshme ishte caktuar si koha kur do të shitej lënda narkotike heroinë. E vendi ishte caktuar te rruga e Durrësit në Tiranë. Pikërisht në këtë kohë ishin bërë gati edhe efektivet e antidrogës së Policisë së Tiranës të cilët kanë sekuestruar 1.5 kilogramë

heroinë të pastër ndërsa ka vënë në pranga edhe 3 persona të cilët dyshohen si posedues dhe shpërndarës së lëndës narkotike. Operacioni i koduar "Trafik 2014" është organizuar

nga strukturat e Luftës Kundër Drogës në Drejtorinë e Policisë Qarku Tiranë, është finalizuar pasditën e djeshme. Mësohet se gjatë hetimeve u arrit identifikimi dhe më pas arrestimi i

3 personave të dyshuar, Lulzim Fregjaj, 56 vjeç, Vilfred Cenolli 49 vjeç dhe Klodian Spahi, 36 vjeç. Burime nga policia bëjnë të ditur se këta 3 persona u kapën në një banesë të ndod-

**KONTROLLI**

**Kondicionerë kontrabandë kapen në Kakavijë**



— Një sasi e madhe kondicionerësh kontrabandë janë kapur në Kakavijë. Aksioni është zhvilluar ditën e djeshme nga Dega Doganore Kakavijë ka mundur të zbulojë dhe më pas sekuestron një sasi të konsiderueshme malli kontrabandë në një kamion që po kalonte tranzit. Pas një kontrolli të plotë fizik të ushtruar në mjedinë e subjektit G.S. M Klimaire sh.p.k nga ana e strukturave të doganës Kakavijë, rezultoi se subjekti në deklaratën e Tranzitit nuk kishte deklaruar mallin "kondicioner" vlera e padeklaruar e të cilit është 35.571 Euro. Ky mall u cilësua kontrabandë pasi ishte në tentativë për të kaluar kontrollin e degës doganore pa u deklaruar më parë. Malli është sekuestruar dhe kompania është penalizuar. Doganat thanë se, lufta ndaj kontrabandës dhe shmangies së detyrimeve doganore do të vazhdojë në çdo pikë doganore të Shqipërisë.



**British American Tobacco Albania sh.p.k.**

Njofton se duke filluar nga data 30 Tetor 2014, çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

MARKA	Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë	MARKA	Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
Kent Nanotek (Infina)	300	Lucky Strike Additive Free (Blue)	260
Kent HD Futura	300	Lucky Strike Red	240
Kent HD (6mg katran)	300	Lucky Strike Blue	240
Kent HD Neo	300	Lucky Strike Red 10 cigare	120
Kent HD Infina	300	Lucky Strike Silver 10 cigare	120
Kent Convertibles	300	Rothmans International	310
Kent Demislms Spectra	280	Rothmans Leggera	230
Kent Demislms Neo	280	Rothmans of London (Blue)	200
Kent HD Neo 10 cigare	150	Rothmans of London (Sky Blue)	200
Kent HD Infina 10 cigare	150	Rothmans of London (Silver)	200
Lucky Strike Click & Roll	260	Peter Stuyvesant Blue	250
Lucky Strike Additive Free (Red)	260	Peter Stuyvesant Silver	250

\*Çmimet shprehen në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me pikën 9.5.3 (ç) të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 17, datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

**British American Tobacco Albania sh.p.k.**  
Tirane, Rr: "Kavajes", ish Kombinati Ushqimor  
web: [www.bat.com](http://www.bat.com)  
office phone: +355 (0) 42 255084

**Vlorë**

**Mbyllet java antitrafik, Gjebrea: Luftë fenomenit**



— Në Vlorë është zhvilluar takimi përmbysllës i Javës Kombëtare Antitrafik, që përkon dhe me 15 vjetorin e themelimit të shoqatës "Vatra", e angazhuar në ndihmë të viktimave të trafikuar. Në këtë aktivitet të zhvilluar ditën e djeshme kanë marrë pjesë zv/ministrja e Punëve të Brendshme, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit Elona Gjebrea, ambasadori i SHBA në Tiranë, Aleksandër Arvizu, ambasadori i BE-së, Romana Vlahutin, ambasadori i OSBE-së, Florian Raunig por edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të pushtetit vendor. Diskutantët pasi vlerësuan hapat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për të luftuar këtë fenomen, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të gjithë aktorëve për të patur rezultate më të larta. Gjatë fjalës së saj, Gjebrea tha se, janë shumë aktivitetet të organizuara gjatë kësaj jave pothuaj 60 të tilla në nivel kombëtar. "Të luftosh trafikimin, nuk do të thotë thjesht dhe vetëm të ndjekësh penalisht çdo trafikant apo bashkëpunëtorët e tyre; do të thotë edhe të mbrosh dhe të japësh mbështetje që viktimat e këtij krimi të rimëkëmbin jetën e tyre, tha ajo.

## Kredia për Shtëpi Alpha Plan

# Ju zgjidhni shtëpinë e duhur! Për të tjerat mendojmë ne...

Të gjithë dëshironi të keni shtëpinë tuaj, por jo të gjithë mund ta realizoni këtë me fondet tuaja. E rëndësishme është të gjeni një partner serioz i cili ju mundëson realizimin e dëshirës suaj duke ju ofruar kushte sa më të favorshme. Kredia për shtëpi **Alpha Plan** nga Alpha Bank është zgjidhja e duhur për të blerë ose riparuar shtëpinë tuaj sepse ju ofron **norma të shkëlqyera interesi**. Për më tepër ju përfitoni:

- **0** komision disbursimi
- **0** kosto për sigurimin e pronës për vitin e parë
- **0** kosto për sigurimin e jetës përgjithmonë

Vizitoni sot një degë të Alpha Bank për t'u njohur me kushtet dhe afatet promovionale të kredisë për shtëpi Alpha Plan. Për më shumë informacion na telefononi në numrin **042 384 174** ose vizitoni **www.alphabank.al**



Vizitoni sot një degë të Alpha Bank  
dhe bëjeni tuajën shtëpinë e ëndrrave!

\*Kjo ofertë është e vlefshme nga data 1 Shtator 2014 deri më datë 31 Dhjetor 2014

\*\*Norma e Interesit për klientët e zakonshëm: EUR: Euribor 3M + 5% / LEK: BTH 3M + 2.5% - Norma e Interesit për klientët pagamarrës: EUR: Euribor 3M + 4.85% / LEK: BTH 3M + 2.35%

\*\*\*Alpha Bank nuk aplikon sigurim jete të detyrueshëm



ALPHA BANK

☎ 042 384 174, 🖱️ [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al)

**VITAMINA** iam ON

**ZBULO  
OFERTËN MUJORE  
MË ENERGJIKE!**

[amc.al/vitamina](http://amc.al/vitamina)

**OFERTA MUJORE ME:**

**FACEBOOK PA LIMIT  
MINUTA PA LIMIT ME MIQTË NË VITAMINA  
150 MINUTA KOMBËTARE  
50 SMS KOMBËTARE  
3GB INTERNET  
MUZIKË PA LIMIT ME AMC DEEZER FALAS**

**VETËM  
800 LEKË  
ME TVSH**

**SHTONI EDHE NJËSI TË TJERA PËR VETËM 200 LEKË!**

Aktivizo ofertën: ☎ 142; AMC Easy #100#; SMS me tekst V te 142



## » “NJEREZIT..”

**NJE DITE** e bukur e kaluar mes njerëzve të apasionuar në Lagunën e Patokut, ku bashkëpunojnë me harmoni shkencëtarët dhe peshkatarët për të ruajtur këtë perlë të natyrës

### Profesori

Profesor doktor Idriz Haxhiu, dekoruar me Urdhërin e Lartë "Naim Frashëri" i klasit të parë dhe me Medaljen e Artë, ka një jetë që studion dhe merret me kërkime shkencore në fushën e biologjisë. Në mjaft rrethe akademike në Europë ai njihet për teoritë e studimit të breshkave të detit caretta - caretta



# Laguna e argjendtë e Patokut

## Reportazh në një prej oazeve të pakta të bregdetit tonë

AGIM PIPA  
TIRANË

Laguna e Patokut, në veriperëndim të vendit dhe rreth 50 kilometra larg Tiranës, si një oaz i kaltër në detin Adriatik, ruan në gjirin e saj perla të argjendta. Peshkatarët zgjojnë ditën të parët, me motoskafët dhe rrjetat e blerta dhe pikërisht këtu, ndanë një stacioni apo një qendër modeste studimore mjedisore, kamera e A1 Report dhe Shqiptarja.com ndjekin shkencëtarin e mirënjohur në fushën e biologjisë së kafshëve në detet shqiptare, prof.dr. Idriz Haxhiu dhe asistenten e tij, biologen e re Vilma Piroli, master shkencor për biologji dhe kandidatet për doktore shkencash. Ata janë të dy në Qendrën Studimore dhe Kërkimore Shkencore prej 15 vjetësh. Por, le t'ju njoh fillimisht me shkencëtarin e urtë dhe modest.

Profesor doktor Idriz Haxhiu, dekoruar me Urdhërin e Lartë "Naim Frashëri" i klasit të parë dhe me Medaljen e Artë, ka një jetë që studion dhe merret me kërkime shkencore në fushën e biologjisë. Në mjaft rrethe akademike në Europë ai njihet për teoritë e studimit të breshkave të detit caretta - caretta. Disa prej tyre ai i ka stacionuar pranë qendrës studimore këtu në Patok dhe pa to, nuk mund të jetojë dot. Profesor Idrizi është me banim në qytetën e Vorës, por prej 15 vjetësh ai ka ndërtuar një tjetër shtëpitë të vogël në Patok; këtu, pranë breshkave të detit. Aty edhe e gjejmë, ndanë një akuariumi të madh pranë stacionit, ku janë konservuar dhe jetojnë disa breshka të mëdha, që para disa javësh kanë qëndruar ndanë brigjeve të detit dhe tash janë edhe ato banore të përkohëshme në Patokun, që ka një jetë që i mirëpret. Një ndihmës i dy studiuesve nxjerr nga akuariumi një breshkë të madhe dhe e sjell mbi një tavolinë të drunjtë. Nisin shpejt e shpejt matjet dhe bëhet matricullimi. Prof. dr. Idrizi fotografon breshkën, ndërsa Vilma shënon të dhënat gjenerale: Numri i breshkës, data e trajtimit dhe AL (Albania) dhe një numur celulari. Pas pak, pas një trajtimi dhe studimi disa ditore, ajo do të lëshohet në det të hapur. Një ditë, breshka mund të jetë në thellësi të detit Adriatik në brigjet e Kroacisë, apo Italisë dhe kolegët e atjeshëm, biologë dhe shkencëtarë që merren edhe ata me studimin e breshkave caretta - caretta, do të mund ta identifikojnë kollaj breshkën, pas marrjes së të dhënave. “Në fakt, - thotë prof.dr. Haxhiu, - këtu janë të shumta breshkat e detit, shtegtare nëpër ujrat e Mesdheut dhe në detin Adriatik, me arsye madhore gjetjen e ushqimit; breshka e zakonshme caretta - caretta është si në shtëpinë e saj dhe, vetëm në muajt prill-gusht të këtij viti, këtu janë numëruar deri 200 breshka të kësaj familjeje. Pastaj vijnë breshkat e rralla helonia mydas, të rrezikuara globalisht për shkak të zhdukjes; delphinët, të disa llojeve; balenat dhe peshkaqenët, të cilët afrohen në Adriatik për t'u ushqyer me breshka këtu. Në Patok gjenden me shumicë sepiet dhe garfortet blu; ngjalat e lagunës, karkalecat e detit. Ndër zogjtë, dallohen pulbardhat që folezizojnë në lagunën e Patokut, karabullakët ose zhytëzat; patat dhe rosat e egra, pelikanët e rikthyer pas viteve të vështira '96-'97 etj”.

### Breshkat

Këtu janë të shumta breshkat e detit, shtegtare nëpër ujrat e Mesdheut dhe në detin Adriatik, me arsye madhore gjetjen e ushqimit



### Peshkimi

“Ne peshkojmë në bazë të rregullave. Gjuetia e peshkut bëhet vetëm në stinët e lejuara dhe ne jemi taksapagues të rregullt, me gjithçka”



### HISTORIA TRONDITËSE E BALENAVE

“Ishte viti 1964, - thotë prof. Idrizi, - Radiot italiane njoftuan se, në ujrat e Adriatikut sapo kishte hyrë një tufë shtegtare balenash, që vinin nga Paqësori i largët. Ardhja e tyre u shoqërua me hedhjen e një rakete dhe tufa e balenave, pas plagosjes së njëres prej tyre, gjeti strehim në brigjet e detit Adriatik, këtu pranë Patokut. Mirëpo këtu i pritri një fat edhe më i keq. Për shkak të padijës, ose injorancës dhe për arsye absurde të politikës së asaj kohe, nën diktaturë, banorë vendas nga një anë dhe trupat ushtarake nga ana tjetër, hapën

zjarr me mitrolozë dhe e vranë balenën e plagosur. Aq u desh që familja e mbetur e balenave, të largohej e tmerruar. Vepër e egër, mizore...” Sot, skeleti i asaj balene gjendet në Muzeun e Shkencave të Natyrës në Tiranë, drejt degradimit të plotë, për shkak të kushteve të këqija të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së atij fosili të rrallë në brigjet e detit Adriatik. Histori tronditëse, e padëgjuar kurrë më parë.

### PESHKATARËT

Vilma dhe prof. Idrizi lenë për pak akuariumin e breshkave dhe vijnë në stacionin e vogël të peshkimit të Patokut. Në lagunë punojnë dhjetëra peshkatarë, organizuar në kooperativa të vogla private. Por kompania më e vjetër dhe më e suksesshme është ajo e familjes Cali, licensuar sipas njërit prej peshkatarëve, Gjergjit, qysh në vitin e largët 1920, në kohën e qeverisë së Mbretit Zog. Prof. Idrizi thotë se bashkëpunimi me peshkatarët për ruajtjen e zonës, të breshkave, shpendëve dhe zogjve që folezizojnë në lagunën e Patokut, është mbreslënës. “Shpesh, kur unë nuk jam këtu, - shton prof. Idrizi - dhe peshkatarët ndeshin me ndonjë tufë breshkash a ndonjë gjallesë tjetër, janë këta që, pasi i mbledhin breshkat me rrjetat e tyre, i sjellin në akuarium. Ndërsa, i pyetur nga unë mbi mbarëvajtjen e punëve në peshkim, peshkatarë i vjetër Cali, thotë: “Peshkimi vitet e fundit ka ardhur i mbarë. Ne peshkojmë në bazë të rregullave dhe në bazë të ligjit. Gjuetia e peshkut bëhet vetëm në stinët e lejuara dhe ne jemi taksapagues të rregullt, me gjithçka. Por, shton ai, ka ende taksapagues të pandërgjegjshëm që, hera - herës, hedhin dinamit në det dhe kjo gjë e dëmton mjaft rëndë lagunën dhe peshkimin. Ne e kemi gjetur gjuhën e përbashkët me shtetin dhe e kemi pasur ndihmën e policisë së zonës, e cila në disa raste, i ka ndëshkuar rëndë kundravajtësit e ligjit.” “A jeton mirë nga ana ekonomike një peshkatar?” - e pyes unë Gjergjin. Ai ve buzën në gaz dhe shpjegon: “Vështirë të thuhet jeton shumë mirë, por ok, mirë jetojmë. Mjafton këtu të citoj disa miq italianë, peshkatarë edhe ata, me të cilët shkëmbejmë eksperiencat tona, që thonë: të paktën ju kemi shtëpitë tuaja... që do të thotë, peshkatarët kudo nëpër botë, nuk bëhen dot të pasur me peshkimin...”

### VILMA

Ajo mban vazhdimisht shënime dhe qëndron pranë prof. Idrizit, në konsulencë me të, edhe pse prof. Idrizi është udhëheqësi i temës shkencore, të cilën ajo do ta referojë pas pak kohësh, për mbrojtjen e titullit Doktore e Shkencave Biologjike. I ka fikur celularët dhe nuk komunikun me askënd, sa kohë punon në lagunë. Kur ndalemi pak, për një kafë, ajo nuk harron të na tregojë se Qendra Kërkimore Shkencore, që drejtohet prej 15 vjetësh nga prof. Idrizi, ka mbështetur në mjaft organizimave dhe shoqatave simotra mjedisore në Europë dhe nëpër botë. Dhe se, sivjet, kjo Qendër pret miratimin e një projekti, që do të mundësojë modernizimin e mëtejshëm të Qendrës kërkimore - shkencore.

Në lagunën e Patokut po bie perëndimi. Me diell të kuq. Bën vjeshtë e butë, e paqtë dhe e begatë...



## Heineken ju dha mundësinë të rinjve shqiptarë të përjetojnë botën në qytetin e tyre!

Heineken organizoi dje në Matrix club, një super party për të rinjtë shqiptarë, duke ju ofruar mundësinë të përjetojnë botën në qytetin e tyre. Këtë sezon, Heineken përzgjedhi kryeqytetet më speciale në botë: Berlin, Amsterdam, Londër, New York, Rio De Janeiro, Shangai dhe i solli në Shqipëri përmes muzikës së zgjedhur, performancës unike të 3 DJ-ve të njohur, shisheve speciale të Heineken dhe show-t artistik.

Super party Heineken ishte pjesë e fushatës “Përjeto botën në qytetin tënd”. Heineken prej dy muajsh ju ka ofruar konsumatorëve të tij magjinë e këtyre qyteteve të mëdha, dhurata speciale, si edhe paketën VIP për fituesit e promovionit në internet, të cilëve ju fali një eksperiencë të mrekullueshme.

Heineken, Open Your World!



## Një Mbretëreshë për mikeshë...

Lagja 15, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës- Shqipëri (Albania) Tel: 052 223094 Fax: 052 22537  
info@teutadurres.com www.teutadurres.com

» VENDORIMI

**SHQIPËRIA** humbet ndeshjen në tavolinë me Serbinë dhe gjobitet 100 mijë Euro, ndërsa Serbisë i zbriten 3 pikë, dënohet 100 mijë Euro dhe 2 ndeshje pa tifozë.

# Skandali UEFA, dhuna dhe racizmi legjitimohen

**FSHF gati apelin, Duka: Vendimi politik, produkt fantazie**

DYLBER BALLA  
TIRANË

UEFA habit gjithë botë duke i dhënë të drejtë Serbisë për dhunën e ushtruar ndaj shqiptarëve, madje duke ligjësuar racizmin në futboll, ndërsa Ivan Bogdanovic që duhet të ishte në burg, nuk i ka bërë aspak përshtypje Disiplinës që nuk e ka "parë" në fushë duke sharë ofenduar dhe kërcënuar kuqezinjët. Për këto dhe shumë të tjera UEFA vendosi që Shqipëria dhe jo Serbia të humbiste ndeshjen në tavolinë 3-0 dhe të gjobitet me 100 mijë Euro. Ndërsa Serbia për të balancuar politikisht dënimin u dënua me heqjen e tre pikëve të fituara ndaj Shqipërisë duke zerruar takimin dhe të dënohet me 100 mijë euro gjobë dhe 2 ndeshje pa tifozë. Vendimi i Disiplinës ishte më pak i mundshmi dhe i prishmi nga të gjithë, pasi Shqipëria u dënua se nuk pranoi të rikthehej në fushë edhe pse u dhanuan fizikisht dhe psikologjikisht si para, gjatë dhe pas ndeshjes tmerrësisht. Ndërsa gjoba vjen si pasojë e lëshimit të dronit në fushë, edhe pse autorësia e këtij të fundit nuk u vërtetua nga pala serbe. Megjithatë edhe nëse do të ishte vërtetuar, ndeshja nuk u ndërpre për këtë shkak, por për hedhjen e sendeve të forta në fushë. Kjo nuk u ka mjaftuar për t'i bindur tre anëtarët e Disiplinës, nga Gjermania, Andora dhe Austria për të vendosur në favor të Shqipërisë. Por, Federata Shqiptare e Futbollit po bën gati dosjen dhe brenda 5 ditëve do ta dorëzojë në Apel. Shqipëria ka më shumë shpresë të Apeli, pasi është më i pavarur sesa Komisioni i Disiplinës, madje disa herë ka qenë në pole të kundërta me qëndrimet e UEFA-s. Presidenti i FSHF, Armand Duka komentoi vendimin dhe rrugën që do të ndjekin më pas për të tentuar pikët në tavolinë. "Vendimi ishte zhgënjyes, nuk ishte i bazuar në rregulla, UEFA nuk dënoi dhunuesit e futbollit. Vendimi ishte një lloj kompromisi dhe jo për të dhënë drejtësi sportive. Nuk e dimë nëse UEFA ka marrë parasysh thirrjet raciste. Nëse jo do kërkojmë të mer-



**Armand Duka**

"Vendimi ishte zhgënjyes, nuk ishte i bazuar në rregulla, UEFA nuk dënoi dhunuesit. Vendimi ishte një lloj kompromisi dhe jo për të drejtësi sportive. UEFA s'ka marrë parasysh thirrjet raciste" tha ai.



**Artan Hajdari**

Avokati i FSHF u shpreh se "Vendimi ka influencë politike. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi në Komisionin e Apelit dhe më tej në CAS. Provat janë më se të plota dhe nga ana juridike" përfundoi ai.



**Anëtar i KE**

Bardhyl Minxhozi "Vendimi nuk ka dhënë drejtësi. Serbia është dënuar të zhvillojë dy ndeshje pa spektatorë por të jeni të sigurt që në stadium nuk do të mungojë Ivan Bogdanovi, dirigjenti i dhunës" tha ai.

ren penalitete për thirrjet raciste. Nuk kam menduar që UEFA do ishte kaq tol-

erante ndaj huliganëve e rrugaçëve. Ky nuk është një vendim i formës së prerë.

Do ta apelojmë vendimin. Kam besim, ngjarja është e qartë. Argumentet i kemi të

**Droni**  
FSHF deklaroi nuk mban asnjë përgjegjësi për hyrjen e banerit fluturues. Siguria është një përgjegjësi e organizatorit. Nuk kishte tifozë shqiptarë në stadium.

**FSHF**  
Lojtarët shqiptarë nuk u njoftuan kurrë që zyrtari i ndeshjes vendosi që takimi të vazhdonte. Ky pozicion është produkt fantazie, nuk refuzuan kurrë ndeshjen.

pakundërshtueshme", tha Duka për A1 REPORT.

**REAGIMI I FSHF**  
"FSHF nuk mban asnjë përgjegjësi për hyrjen e banerit fluturues. Siguria është një përgjegjësi e organizatorit. Nuk kishte tifozë shqiptarë në stadium. - Ka prova të qarta mjekësore që lojtarët e ekipit shqiptar ishin të paafekt të luanin, si pasojë e dëmtimeve, që rrodhën nga dhuna e tifozëve vendas që hynë në fushë. - Ndëshkimet janë dukshëm të padrejta, sepse thuajse barazojnë dënimet. Një stadium që ofroi parulla etnike, politike dhe fetare, urrejtje raciale u ndëshkua në mënyrë të njëjtë, me një baner të vetëm, të paligjshëm dhe me origjinë të pavërtetuar. - Shkaqet finale që çuan në braktisjen e ndeshjes ishin mungesa e sigurisë dhe dhuna. Lojtarët shqiptarë nuk u njoftuan kurrë që zyrtari i ndeshjes vendosi që takimi të vazhdonte. Ky pozicion është produkt fantazie. Skuadra shqiptare nuk refuzoi kurrë të vazhdonte ndeshjen. Nuk ka referencë, në raportet zyrtare që zbraza të stadiumit ishte mënyra e përshtatshme. Ne nuk mund të pendohejmë për një vendim që s'kemi marrë. Ishte një pamundësi për të luajtur dhe jo refuzim.



**GAZPROM**  
Rusia ndikoi në vendimin e UEFA-s?

Pas vendimit të UEFA-s për të dënuar Shqipërinë në media po lakohej se Komisioni i Disiplinës u dirigjua nga Rusia. Mendohet se ky vendim i UEFA-s është ndikuar nga gjiganti rus i gazit, Gazprom. Gazprom është sponsori kryesor i UEFA-s dhe pronarët janë miq të vjetër të Michel Platini. Po ashtu, në Serbi do të ndërtohet së shpejti një gazsjellës i cili do të lidhë Evropën-Juglindore e natyrisht se aty iniciativën kryesore e ka pasur Gazpromi sepse gazsjellësi është i financiar nga Rusia. Një prapaskenë kjo mjaft serioze, por që ende nuk ka ndonjë konfirmim po ashtu serioz. Megjithatë ajo që dihet është fakti që Rusia gjithmonë ka qenë në krah të Serbisë për gjithçka, e nuk ka si të mungojë në futboll.

**Numrat dhe shumat fituese**  
Shorteu i datës **23 Tetor 2014**

**LOTO** 39

Fitues për çdo kategori

Nuk ka fitues	Gjashtë	23,101,659 Lekë
1	Pesë	28,946 Lekë
28	Katër	1,085 Lekë
326	Tre	211 Lekë
1,996	Dy	100 Lekë

Numrat e parashikuar saktë

Shuma në dispozicion

Lotaria Kombëtare  
Mosha minimale për pjesëmarrje është 18 vjeç.  
Për më shumë info: Tel 04 451 1000  
www.lotaria.al

Pagesa e çmimeve fituese i nënshtrohet tatimit në burim, në zbatim të ligjit.





# “Platini më fal për stolin që desh e thyeva me kokë”

## Sulmuesi i kombëtares ironi me UEFA-n

### Vendimi

DYLBER BALLA  
TIRANE


**V**endimi i UEFA-s ka sjellë reagimet e të gjithë shqiptarëve, drejtuesve dhe lojtarëve të ekipit kombëtar, teksa nuk kanë munguar komentet e Presidentit të Federatës së Kosovës. Ndërsa në Kosovë kanë nisur protestat nga “Plisat” me thirrjet “UEFA = MAFIA” ndërsa sot do të zhvendosen në Zvicër para selisë së UEFA-s.

### DE BIASI: NA HOQËN ATË QË FITUAM

Trajneri i Shqipëri, Gianni De Biasi u shpreh shumë i zhgënjyer pas vendimit të UEFA-s. “Jam i zhgënjyer për një vendim që nuk na jep drejtësi. E kuptoj komisionin, por besoj se për ne është shumë e vështirë për ta pranuar një vendim që na bën të ndihemi të mposhtur nga të gjitha frontet. Na hoqën edhe atë që kishim fituar në fushën e lojës! Çfarë duhet të ndodhte më shumë?”

### CANA: KJO NUK ËSHTË DREJTËSI

Kapiteni i Kombëtares



shqiptare, Lorik Cana, e ka komentuar shkurt vendimin e Komisionit Disiplinor të UEFA-s. “Kjo nuk është drejtësi”, ka shkruar Cana në profilin e tij në Facebook, disa orë pasi u zyrtarizua vendimi i UEFA-s.

### BALAJ: I KËRKOJ “FALJE” PLATINISË

Sulmuesi i Shqipërisë, Bekim Balaj ka shprehur pakënaqësinë ndaj vendimit që i dhuroi Serbisë fitoren. Bala, i cili u godit me stol në kokë nga një huligan serb, në mënyrë ironike e falënderoi presidentin e UEFA-s, Platini, për vendimin. “Më fal Platini për stolin që desh e thyeva me

### Trajneri

“Na hoqën edhe atë që kishim fituar në fushën e lojës! Çfarë duhet të ndodhte më shumë?” tha De Biasi

kokë, bravo Uefa”, ka shkruar Balaj.

### MEHA: NGREMË FLAMURIN NË FRANCË

Mesfushori i kombëtares shqiptare, Alban Meha u ka premtuar tifozëve shqiptarë se do të kualifikohen dhe do

ta ngrënë Flamurin Kuq e Zi në mes të Francës. “Padrejtësia na bën më të fortë, do kualifikohemi me forcat tona dhe do shkojmë ta ngrëm Flamurin KUQ E ZI në mes Francës, vetëm kundra të gjithëve sa më shumë të na dëshojnë aq më shumë do na bashkosh”.

### XHAKA: TURP I BOTËS... F\*\*\* UEFA

Taulant Xhaka ka reaguar në rrjetet sociale pas vendimit të Komisionit të Disiplinës. Futbollisti i Kombëtares sonë thotë se kjo është e turpshme. Ai nuk ngurron që të lëshojë edhe sharje ndaj UEFA-s, pas revoltës për këtë vendim. “Turp turp i botës, F\*\*\* UEFA”, shkruan Xhaka.

### MAVRAJ: UEFAJË, ÇËSHTJA VAZHËD

Mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Mergim Mavraj ka bërë thirrje për tifozët shqiptarë, se ky rast, nuk mbaron pas këtij vendimi. “O Shqipë çfarë keni?! Çështja vazhdon! Nuk mbaron vetëm me vendimin e Uefaviç”, ka shkruar Mavraj.

### VOKRRI: VENDIMI I UEFA-S SKANDALOZ

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri e ka cilësuar skandaloz vendimin e UEFA-s. Ai nuk ngurron ta quajë politik këtë vendim, në favor të Serbisë dhe në dëm të lojtarëve kuqezinj. “Vendim skandaloz. Është një vendim politik i UEFA-s. Kur sulmohen lojtarët, UEFA vendos në favor të Serbisë”, tha Vokrri.

### “BOMBARDOHET” UEFA NGA SHQIPTARËT

Institucioni më i lartë i futbollit evropian, UEFA, është bombarduar nga shqiptarët në faqen zyrtare në Facebook. Përveç raportimeve të shumta që mund të ndikojnë në mbylljen e faqes zyrtare të UEFA-s në Facebook, janë edhe mijëra komente që janë postuar si komente të vendimit të publikuar në këtë faqe. Deri në orët e vona të mbrëmjes së djeshme numri i komentuesve që fyenin dhe ofendonin UEFA-n dhe Platinit arrinte në 60 mijë.

### “PLISAT” PROTESTË “UEFA = MAFIA”

Grupi i tifozëve prishinas “Plisat” zhvilluan një protestë në Kosovë kundër vendimit të UEFA-s. Në pankartat e tyre ata shkruanin “UEFA = MAFIA” teksa nuk mungonin edhe thirrjet kundër Platinit. Sot ata kanë premtuar një protestë para selisë së UEFA-s në Zvicër.

### THE GUARDIAN:

“Boll më”  
mjajt e  
ledhatuat  
Serbinë

— Vendimi i UEFA-s për ndeshjen Serbi-Shqipëri ka habitur mediat europiane dhe ato ndërkombëtare duke bërë që shumë prej tyre të reagojnë ashpër. Sipas Toscana News, vendimi i sotëm i UEFA-s ka legjitimuar dhunën dhe racizmin. BBC thotë se Serbia është shpërblyer me një fitore të lehtë kundër Shqipërisë, pas dhunës së shpërthyer në stadium. Ndërsa sipas të përditshmes italiane, “La Gazzeta dello Sport”, të gjithë janë humbës me vendimin e UEFA-s duke kritikuar këtë të fundit për faktin që nuk ka marrë masa parandaluese për shmangjen e incidenteve të ngjashme të cilat janë zgjeruar së fundmi në futbollin evropian. “Deutsche Welle” dhe “Reuters” shkruajnë se Serbia mori fitoren, por jo pikët, duke shtuar se Shqipëria ka vendosur të apelojë vendimin. The Guardian me anë të një shkrimi të gazetarit, Owen Gibson, ka kritikuar vendimin e UEFA-s dhe Serbinë, duke thënë se lista e akuzave ndaj këtij vendi është deri në absurditet e gjatë dhe se nuk duhet të falej nga UEFA, por të dënohej.



### Protesta

Grupi i tifozëve prishinas “Plisat” zhvilluan një protestë në Kosovë kundër vendimit të UEFA-s. Në pankartat e tyre ata shkruanin “UEFA=MAFIA”

### Deklaratat

TIRANE

**S**erbia është e pangopur. Edhe pse fitoi në tavolinë dhe dëmet u minimizuan nga UEFA, përsëri do të kërkojë që t’i rikthehen pikët nga Apeli. Ndërsa presidenti Karadziç sipas medieve serbe ka vendosur që të largohet pas dështimit dhe paraqitjes së dobët këtë edicion. Nga vendimi nuk ka mbetur e kënaqur as Danimarka që ka shitur biletat e ndeshjes me Serbinë.

### SERBIA APELON, KARADZIÇ LARGOHET

Serbia ka shprehur pakënaqësi ndaj vendimit të UEFA-s për ndeshjen duke thënë se do të apelojë vendimin, ashtu si Federata Shqiptare e Futbollit. Serbia nuk është e kënaqur me heqjen e tre pikëve të fituara në tavolinë. Ndërsa Presidenti i FFS, Karadziç sipas medieve serbe do të japë dorëheqjen si pasojë e

# Serbia apelon vendimin, Karadziç ikën pas dështimit

## Danimarka kundër: Kemi shitur biletat për ndeshjen me Serbinë

presionit dhe paraqitjes zhgënjyese të kombëtares.

### ADVOCAT: U DËNUA VETËM SERBIA

Për cudinë e të gjithëve, trajneri holandez i Serbisë, edhe pas vendimit për tre pikët nuk është i kënaqur. “Shqiptarët dolën të palagur nga ky vendim. Nuk e kuptoj se pse jemi ndëshkuar ne, pasi ishin ata që nuk dëshironin të luain. Unë mendoj se dikush dëshiron që Serbia të mos jetë në Euro 2016. E quditshme, kemi luajtur dy ndeshje, dhe nuk kemi humbur asnjë, kemi një



fitore dhe një barazim, por vetëm një pikë. Edhe pa tifozë ne do të bëjmë maksimumin

që të kualifikohemi”.

### DANIMARKA KUNDËR VENDIMIT

Vendimi i Komisionit të Disiplinës së UEFA-s lë të pakënaqur edhe Federatën Daneze të Futbollit e cila ka deklaruar se luajtja e sfidës kundër Serbisë pa tifozë, penalizon tifozët e saj.

“Vendimi për ta luajtur ndeshjen pa tifozë dëmton mbështetësit e Danimarkës të cilët kanë blerë biletat për sfidën kundër Serbisë që përpara vendimit të UEFA-s”, thuhet në deklaratën e Federatës Daneze.



# Nishani: Vendim i padrejtë, racizmi kundër vlerave të BE

Presidenti: Të bësh veshin shurdhër ndaj racizmit, absurde

Një vendim aspak të drejtë dhe të paekuilibruar e ka cilësuar Presidenti Bujar Nishani vendimin e UEFA-s për ndeshjen Shqipëri-Serbi. "Përtej interpretimit teknik të UEFA-s dhe të qenit të saj një autoritet i pavarur, vendimi i dhënë nuk qe as i drejtë, as i

ekuilibrar dhe as një shembull i mirë. Sporti i bashkon popujt. Por po njëlloj dhe drejtësia, që kur s'është e tillë më shumë dëmton se sa bashkon. Dënimi ndaj racizmit ka qenë një fitore e madhe e vlerave perëndimore që është arritur me shumë sakrificë", thotë Nishani në

facebook. Për të, të bësh veshin shurdhër ndaj akuzave për racizëm bie ndesh me vlerat e BE. "Të bësh në 2014 veshin shurdhër ndaj akuzave për racizëm e dhunës së ushtruar nga motive raciste është një qëndrim që bie ndesh jo vetëm me vlerat që përcjell sporti, si solidariteti dhe ol-

impizmi, por dhe me vlerat e BE ku shqiptarët aspirojnë të integrohen. Ptoj të gjithë të shtojnë përpjekjet që zëri që kërkon dënimin e racizmit të dëgjohet, e fajtorët të marrin dënimin që meritojnë. Kjo drejtësi do t'i shërbente më mirë fqinjësisë së mirë në rajon", reagon Nishani.



Presidenti Bujar Nishani



Ajo që futbollistët shqiptarë bënë në stadiumin "Partizan" në Beograd në përballjen ndaj Serbisë u cilësua nga Kryeministri Edi Rama si më e madhe sesa tre-pikëshi që mund të merrte në tavolinë kombëtarja shqiptare. "S'jemi nisur të fitojmë kampionatin evropian dhe as e kërkojmë këtë nga futbollistët tanë. Fitortja e asaj nate ishte me e madhe se 3 pikë", tha Kryeministri. Në një konferencë për mediat nga selia e Këshillit të Ministrave, Rama ka komentuar vendimin e UEFA, për të cilin ai tha se me këtë vendim për të vënë një shenjë barazimi mes Serbisë dhe Shqipërisë, UEFA i vuri vetes një minus të madh.



Kryeministri Edi Rama

# Rama: UEFA vendim politik, nuk bëri drejtësi për "Beogradin"

"Vuri shenjë të padrejtë barazimi. Ajo që kombëtarja bëri, më e madhe se 3 pikëshi"



tema e racizmit do të jetë një temë themelore, me të drejtë, në rekursin e FSHF, pasi në shkallën e parë, praktikisht, janë paraqitur të gjitha provat në raport me objeksionet e bëra nga vëzhguesit, arbitri e

kështu me radhë", tha Rama. Ai shprehu mbështetjen e Qeverisë për Kombëtaren shqiptare të Futbollit, ndërsa shtoi se fitortja e madhe e futbollistëve të Kombëtares

mishërimi i kombit tonë. Kjo është fitortja e madhe e tyre nën fanelën Kuq e Zi dhe misioni i tyre nuk është të fitojnë kampionatin Evropian, por atë të mishërimit. Mbështetja

## AMBASADORI FRANCEZ

"I kënaqur që s'jam ambasador i UEFA-s pas vendimit për Serbi-Shqipëri. Futboli lojë serioze, s'duhet t'i besohet politikës. Më i rëndësishëm bashkëpunimi midis shteteve" tha Fitoussi.

ishite mishërimi i tyre. "Djemtë e Kombëtares e trajneri i mençur me eksperiencë, nuk duhet të ligëshohen nga padrejtësia e sotme (dje). S'duhet të harrojmë se shkuan në Beograd si futbollistë e u kthyen si

Lulzim Basha. "Ju shpreh keqardhjen time më të sinqertë për zjarrin që u ka rënë në kokë. Jam po aq i zemëruar sa kushdo prej tyre. Por s'dua që zemërimi të na djeg qarkun e arsytimit. Pasi bëhemi më

## KRYEMINISTRI:

"Shkodër, gati 20 mijë zemra Kuq e Zi"



Kryeministri Edi Rama bëri të ditur se stadiumi i ri i Shkodrës do të jetë gati më datën 11 tetor 2015, datë e cila përkon me inaugurimin e stadiumit "Elbasan Arena". Kreu i qeverisë tha se ndeshja e radhës me Serbinë do të zhvillohet në këtë stadium. Më tej Rama shtoi se ky stadium do të mbajë një kapacitet prej 20 mijë tifozash. "Sot kam marr dhe një vendim, për t'vënë një datë të stadiumit të ri të Shkodrës, 11 tetor 2015. Në ndeshjen e kthimit Shqipëri-Serbi, do të ketë vend për të paktën 20 mijë zemra Kuq e Zi. 11 tetori më është fiksuar nga çelja e stadiumit të Elbasanit dhe përfundimin në 11 tetor e shoh si momentin për të bërë gati çeljen e stadiumit", tha Rama. I cili nuk ka munguar të deklarojë se Shqipëria do të japë shembull civilizimi, duke këmbëngulur sërish se FSHF do të shkojë deri në arbitrazh.

gesharakë para botës. UEFA ka dhënë një vendim politik. Por UEFA s'i dëgjon ankimet e Qeverive. Kush i jep receta të kritikizimit ballkanik është i paditur", tha Rama.

## LAJME shkurt



### Doda: UEFA si vendimet E gjykatave shqiptare

Deputetja demokrate Mesila Doda, tepër kritike ndaj lidershit të Partisë demokratike dhe kreut të saj Lulzim Basha dhe një qëndrimin ndaj vendimit të UEFA-s për ndeshjen Serbi-Shqipëri, ka një qëndrim të ndryshëm. Duke akuzuar drejtësinë shqiptare, gjë që lidershipi i PD nuk e ka bërë deri më tani, Doda krahason me të vendimin e UEFA-s, që dha vetëm padrejtësi. "S'di pse mu duk si vendimet e zakonshme të gjykatave shqiptare. Pas kësaj mos u ankoni më për drejtësinë, gjithandë njësoj është", deklaroi Doda.



### URFA, Basha: Rama lëri llogjet por angazhohu

Kryetari i PD, Lulzim Basha ka reaguar nëpërmjet një statusi në Facebook, për vendimin e Komisionit të Disiplinës së UEFA-s në lidhje me incidentin e 14 tetorit në stadiumin "Partizan" të Beogradit gjatë ndeshjes Serbi-Shqipëria. "I padrejtë vendimi i UEFA-s. Kryeministri ti lëri llogjet, të angazhojë të gjitha resurset e shtetit në mbështetje të Kombëtares dhe një vendimi të drejtë bazuar mbi të vërtetën", shkruan Basha. Dhe Bogdani thotë se "Rama dështoi, asnjë minutë nuk bëri lobim për kombëtaren".

# Kur flet Halimi...



NGA GËZIM ZILJA

vijon nga faqja 1

Në Kushtetutën e Shqipërisë thuhet ndër të tjera: Gjyqtari mund të shkarkohet nga KLD-ja për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore dhe fizike, për sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmërinë profesionale (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 147, pika 6). Nëse do të kishim një Këshill të Lartë Drejtësie funksional, kuptohet që gjykatat nuk do të ishin të mbushura me delenxhinj, hajdutë e mashtrues. Prandaj

reformimi është një nevojë e kohës.

Parlamenti i sotëm, kryesisht mazhoranca, në këtë kuadër ka vendosur të shkarkojë nënkryetarin e KLD-së, zotin Çefa dhe për këtë ka ngritur argumentat e veta. Natyrisht, zoti Çefa, si një drejtues i lartë në sistemin gjyqësor, bëri dhe do të bëjë mbrojtjen e vet, duke mos pranuar akuzat për shkarkimin e tij. Opozita, nga ana e saj, është hedhur në sulm për mbrojtjen e Çefës me anë të përfaqësuesit të saj, deputetit Eduard Halimi, ish-ministër Drejtësie në qeverinë Berisha. Tepër i shqetësuar, Halimi deklaroi: I bëjmë thirrje (sa herë del në podium, Halimi bën thirrje, duke kërcënuar me gishtin e tij tregues...) Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë sa më shpejt çështjet e ngritura para saj. I bëjmë thirrje çdo gjyqtari të kësaj Gjykate dhe gjithë sistemit gjyqësor: Mos u gjuhëzoni para presionit të krimit dhe mafies së veshur me pushtet!

Halimi dhe gjithë deputetët e PD-së kanë qenë dakord (mendoj që ende janë dakord) që sistemi i drejtësisë në Shqipëri është një kancer i tmerrshëm dhe mjerëz ata që kanë pasur punë me të. Flasin për sistem të drejtësisë dhe jo për individë të paktë (gjyqtarë) në

se ka, që mund të bëjnë përjashtim.

Së pari, Halimi me shokët e tij duhet të sqarojnë e bindin shqiptarët se pse po bëhet një padrejtësi për shkarkimin e Çefës e jo të blujnë ujëm dhe së dyti a e dëgjon veten e tij kur flet e bën thirrje në emër të Partisë Demokratike, "... gjithë sistemit gjyqësor të mos gjuhëzohet para krimit e mafies së veshur me pushtet?" Po vetë sistemi gjyqësor ka trajta të një mafie që ka kapur shtetin shqiptar! Këtë e ka pohuar pozita, opozita dhe veçanërisht ndërkombëtarët. Cilët të rezistojnë, zoti Halimi: hajdutit, mashtruesit dhe banditët e sistemit të drejtësisë në Shqipëri? Cilët janë ata që duhet të rezistojnë? Nëse është fjala për ca individë të Drejtësisë, dakord, po sa për sistemin...?! Po përgatitu, o mjeri, kur del e flet e këshillohu me miq e shokë, atje në të njejtin ton patetik, Halimi vazhdon:

Partia Demokratike i bën thirrje (sërisht thirrje) sot gjithë faktorit ndërkombëtar të hapë sytë para asaj që po ndodh në Parlament, ku njerëzit e krimit vendosin të shkarkojnë anëtarët e KLD-së; njerëzit, që qeveritë e tyre kërkojnë të ekstrado-

jnë, dënojnë sot anëtarët e KLD-së dhe kërkojnë të marrin KLD-në, shkollën e magistraturës dhe gjithë sistemin e drejtësisë.

Po qetësohu e fol shtuar, zoti deputet! Faktori ndërkombëtar, ai në Evropë dhe ai tjetri matanë Atlantikut, ka njëzet vjet që flet e kërkon reforma në sistemin e Drejtësisë shqiptare. Nëse kjo reformë, që po tentohet të kryejë mazhoranca, nuk është e duhura dhe kërkon të bëjë zëvendësime pa prekur sistemin, ja ku është Parlamenti, ja ku janë komisionet, podiumet e mediat; të argumentohet gjithçka, duke i referuar ligjeve dhe fakteve. Se ndoshta faktori ndërkombëtar vazhdon të mbajë sytë e mbyllur e nuk e dëgjon thirrjen e Halimit nga podiumi i PD-së!?

Halimi pretendon se ka parë një kriminel, që është strehuar në makinën e një deputeti, kur po e ndiqte policia, madje i ka marrë dhe targën. Epo kjo



nuk ka kuptim fare. Po pse nuk e denoncon, po na tregon përalla e fjalë-kryqe me mbret e mafiozë? Duhet të keni më shumë respekt për ata që ju kanë zgjedhur, z.Halimi! Shko e mbroje Çefën dhe sistemin e drejtësisë, që ngrite për tetë vjet, atje ku është për t'u mbrojtur, me durim, me gjaktohtësi, me drejtësi, me logjikë e vendosmëri. Jo nga maja e podiumit dhe as nga dritarja e bunkerit. Të jesh i sigurt që njerëzit do të të kuptojnë.

Sa për faktorin ndërkombëtar, ai hapur i ka sytë. Po ti mirë e ke, xhanëm, se bën vakti (ndodh) që ndonjë flegjumë dhe e zgjojë cicërimat e tua...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

## FTESË PËR OFERTË

**1.** Ministria e Kulturës, me fondin limit të vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit prej 28.000.000 (njëzet e tetë milion) lekë me TVSH në kuadër të projektit "Festivali i Dritave", si dhe në mbështetje të Vendimit nr. 709, datë 24.10.2012 "Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore" zhvillon procedurën e përzgjedhjes së ofertave nga operatorët e specializuar për realizimin e projektit "Festivali i Dritave", që do të zhvillohet në datat 28-29 Nëntor në kuadër të festimeve të 70-vjetorit të Çlirimit të vendit.

**2.** Përzgjedhja e operatorëve të specializuar, do të behët sipas kushteve të mëposhtme:

- Çmimi i ofruar nga operatorët e specializuar në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara bashkëlidhur.

### OBJEKTI:

"Festivali i Dritave", 28.000.000 (njëzet e tetë milion) lekë me TVSH.

- Ofertat ekonomike të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara bashkëlidhur.
- Dokumentacioni i specifikimeve teknike dhe ligjor i kësaj procedure, e gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës [www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al).
- Afati i fundit i paraqitjes dhe hapjes së ofertave është 29/10/2014 ora 10:00, në Zyrën e Protokollit pranë Ministrisë Kulturës.
- Ofertues apo Përfaqësues të autorizuar të tyre janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

## REZULTATET E

# LOTO

Shorteu datë:  
19.10.2014

06 07 11 14 17 23

Shorteu datë:  
23.10.2014

02 05 07 13 24 33

## REZULTATET E

# FITOFITO

		Numrat Fitues				Simboli
E Premte	17.10.2014	4	2	8	8	
E Shtunë	18.10.2014	2	3	8	7	
E Diel	19.10.2014	5	4	0	9	
E Hënë	20.10.2014	4	1	8	5	
E Martë	21.10.2014	8	6	2	5	
E Mërkurë	22.10.2014	8	5	1	7	
E Enjte	23.10.2014	5	6	9	1	

LOTARIA KOMBËTARE  
by austrian lotteries

Mosha minimale për pjesëmarrjen në lojërat e Lotarisë Kombëtare, është 18 vjeç.  
[www.lotaria.al](http://www.lotaria.al)



NGA ARBEN DUKA

## SATIRË POLITIKE

# Serbët-njerëz të dëshpëruar e arrogantë, portë përkrahur nga Europa!

Ç'janë në të vërtetë,  
pamë dhe këtë herë,  
me radhë Vuçiqin,  
dhe viç-ët e tjerë!

E njohim me kohë,  
sojin e Vuçiqit,  
pasardhës i denjë,  
i Millosheviçit!

Vetëm poshtërsi,  
shoh pas çdo fytyre,  
s'mund ta ulim kokën,  
kurrë para tyre!

T'i urresh kasapët,  
është fare pak,  
se duart e tyre,  
ende janë me gjak!

Brenda hartës tyre,  
ndihen shumë shtrënguar,  
dhe sot kombi serb,  
është i dëshpëruar!

Janë të dëshpëruar,  
e s'përmbahen fare,  
duke promovuar,  
anën më barbare!

Shpalosen me lehje,  
si kryezagarë,  
s'di si barbaria,  
mund t'i bëjë krenarë!..

Dhe i pari i tyre,  
flet si karabush,  
por qenit që leh,  
s'e ka frikë askush!

Ata dinë vetëm,  
gjuhën e hanxharit,  
por s'është dredhur kurrë,  
syri i shqiptarit!

Ata meritojnë,  
të digjen në Ferr,  
por çudi-Europa,  
me të mirë i merr!

Bën sikur s'shikon,  
ku ushqehet krimi,  
dhe me kombin tonë,  
vë shenjë barazimi!

Dihet kush e bën,  
këtë katrahurë,  
serbi me shqiptarin,  
s'barazohen kurrë!

UEFA po bën,  
një turp të vërtetë,  
dhe s'shikojnë kush është,  
ende në Mesjetë!

Si nuk i dëgjojnë,  
thirrjet gjakatare,  
që e ka dhe shteti,  
politikë zyrtare!

Juve të BE-së,  
mbase mënd e mbani,  
si u tolerua,  
dikur Sllobodani!..

Se e toleruan,  
për turp Sllobodanin,  
ndaj në një thertore,  
e ktheu Ballkanin!

Tri pikë s'diskutohen,  
për rastin në fjalë,  
të dënohen rëndë,  
këta kanibalë!

Nëse merren masa,  
dhe kundër shqiptarit,  
them se vetë UEFA,  
i hedh benzinë zjarrit!

Nuk bëhet më fjalë,  
hiç për ato pikë,  
se serbët e bënë,  
konflikt politik!

Duket zemër shumë,  
kanë marrë hordhitë,  
se flamujtë tanë,  
po dëgjin çdo ditë!..

Neveri pa fund,  
këto ditë ndjej unë,  
dhe s'është gjë e re,  
që dhuna pjell dhunë!

Që kjo të kuptohet,  
s'është aspak vështirë,  
turp kush kriminelët,  
i merr me të mirë!



Tomislav Nikolić dhe Aleksandër Vuçiq

## Baladë

## TRUMPETA E ZOTIT..

O mendime që më vini,  
turbull porsì valët,  
dhe me aromë pelini,  
m'i vishni gjith' fjalët.

Që ju linda-që ju rrita,  
porsi kanakarë,  
në udhëkryq dhe në prita,  
pse më gjete zvarrë?

Më lëviz damari i ballit,  
si një eksplozion,  
porsi Shtëpia e Djallit,  
koka më gjëmon.

Ç'më sjellin këto mendime,  
gjith' këto meraqe,  
moj e shkreta jeta ime,  
që nuk gjete paqë!..

Moj e shkreta jeta ime,  
me ato vullkane,  
me të thinjurat mendime,  
në bor' e tufane..

O mendime-o mendime,  
që më hapët punë,  
u thinjësi si nyjeka ime,  
u thinjësi unë.

O mendime që në zemër,  
më digjni si eshka,  
ju kini turrit e dritës,  
unë eci si breshka.

Se shkrihet poet' i shkretë,  
në ballin e shqotës,  
dhe shkurton të tijën jetë,  
që të zgjasë të Botës.

Ndez e ndez ky i bekuar,  
një dritëz me territ,  
veç Ai i ka jetuar,  
mundimet e Ferrit.

Asnjëherë në krahë të tija,  
nuk shënoi balanca,  
tretet si vesa-si hija,  
kur flet injoranca.

Mund të mposhtë gjarprin me zile,  
të mundë një kuçedër,  
po pushtet' i injorancës,  
është më i egër.

Veç në qiell-pranë Fronit,  
do t'ish i pushtetshëm,  
poeti dhe injoranca,  
armiç të përjetshëm.

Pak janë flladet dhe aromat,  
që e përkëdhelin,  
gjëmbat rritet me shumicë,  
lutem zëni çelin.

O mendim që vret Arbenin,  
me gjyle të rënda,  
unë i jap jetës melhemin,  
ajo më jep gjëmba!

Po nuk trëmbem-po nuk tutem,  
jo nga kjo përpjekje,  
dhe në tufë jo, nuk futem,  
të më gjesh-moj vdekje!


Se unë jam Trumpetë e Artë,  
në buzët e Zotit,  
që i ndez vullkan të zjarrtë,  
kohës së Robotit!..

Dhe nuk pres nga njerëzia,  
të më bëjnë gjyqin,  
se përmbi supet e mia,  
vetë e hodha kryqin.

Me injorantët s'luftoj,  
kurrë në një pjacë,  
se vërtet këtu jetoj,  
por jam tjetër racë!

## » REAGIMI

**KËNGËTARJA** e cila prej javësh ndodhet në Tiranë së bashku me bashkëshortin e saj, ka befasuar javë pas javë me performancat në spektaklin "Dance With Me"



# Nora ISTREFI

## S'jam shtatëzanë, por edhe sikur të isha nuk e bëj publike

Këngëtarja prej disa javësh ndodhet në Shqipëri si pjesëmarrëse e "Dance With Me"

**N**ora është shtatëzanë! Kjo ka qenë kryefjala e lajmeve rozë, por ajo çka vetë Nora ka konfirmuar ka qenë befasuese. Këngëtarja e cila prej javësh ndodhet në Tiranë së bashku me bashkëshortin e saj, ka befasuar javë pas javë me performancat në spektaklin "Dance With Me". E kontaktuar nga gazeta, Nora ka rrëfyer se nuk është shtatëzanë, por edhe nëse do të ishte nuk do ta bënte publike. "Nuk jam shtatëzanë, por edhe po të isha nuk do të thoja sepse është personale", ka shprehur Nora. Edhe


pse Nora nuk e ka pranuar lajmin se është shtatëzanë, thuhet se të afërmit e çiftit Istrefi-Berisha janë në dijeni. Ndërkohë, këngëtarja është e angazhuar aktualisht me spektaklin e kërcimit "Dance With Me", koha mbetet të zbuloj të vërtetën. Kujtojmë se, mbrëmjen e 2 shtatorit

këngëtarja Nora Istrefi kurorëzoi lidhjen e saj shumë vjeçare të dashurisë në martesë me muzikantin Robert Berisha. Nora është shfaqur e mrekullueshme me fustanin e bardhë në çdo detaj ndërkohë që ka shkëlqyer në krah të bashkëshortit të saj Robertit.

### Reagimi

## Vipat shqiptar reagojnë pas vendimit të UEFA-s

**P**as dhënies së vendimit të UEFA-s në disfavor të Shqipërisë nuk kanë qëndruar pa reaguari personazhet e artit shqiptar. Me anë të postimeve në rrjete sociale emra si Miriam Cani, Evi Reçi, Juliana Pasha e shumë të tjerë kanë shprehur indinjatën për këtë vendim të marrë nga UEFA. Marina Vjollca mendon se vendimi i UEFA për të ndëshkuar me disfatë Shqipërinë është i neveritshëm. Listës së kritikëve i është bashkuar edhe bukuarshja e Top Channel, Marina, e cila kërkon edhe "Shqipërinë etnike". Ndërsa, Dafina Zeqiri thotë se pavarësisht se na morën meritat e ndeshjes, shqiptarët sërish kanë dalë fitues. Në një postim të saj në Facebook këngëtarja kosovare thotë se ne kemi fituar shumë më shumë se sa UEFA mundet me na marr. Ndërkëq, Altuna Sejdiu thotë se pavarësisht vendimit të



padrejtë që iu bë futbollit shqiptar nga UEFA, ne duhet ta mbajmë kokën lart. "Padrejtësitë dhe konfirmimi i racizmit nuk janë befasi. Sporti duhet të jetë larg nga politika. Jemi fituesit më të mëdhenj. Të mbajmë kokën lart", shkruan Tuna.

### Seldi

## Nuk do të ketë bashkëpunim midis meje dhe Sinanit



— Këngëtarja Seldi Qalliu i ftuar në emisionin "Top Show", për të folur mbi videoklipin "Digjet Ballkani", klip të cilin ai e realizoi menjëherë pas ndeshjes Serbi-Shqipëri ka bërë një deklaratë të fortë mbi bashkëpunimin me këngëtarin Sinan Hoxha. "Nuk do të ketë më bashkëpunim midis meje dhe Sinanit" - ka deklaruar Seldi me ton bindës, duke lënë të kuptohet se miqësia e fortë mes dy këngëtarëve ka përfunduar. Megjithatë nuk hodhi poshtë faktin se miqësia mes të dyve i solli sukses në karrierën muzikore, Seldi konfirmoi se ai është vetëm në treg dhe do të tentoi suksesin vetëm.

## Kalendari Kulturor

### TEATRI KOMBËTAR

- "Vanja, Sonja, Masha etj.", quhet komedia shkruar nga Christopher Ferdinand Durang, nën regjinë e Dervishit, e cila do të vijë këtë fundjavë në datat 24, 25, 26 tetor në skenën e Teatrit Kombëtar. Në role interpretojnë aktorët Yllka Mujo, Neritan Liçaj, Olta Dako, Adelina Muça, Valina Muçolli dhe Besmir Bitraku. Kritika e ka cilësuar veprën si më të suksesshmen e dy viteve të fundit, por edhe nga pjesët më të zgjuara të komedive bashkëkohore. Çehovi zhvendoset, rifikohet e sillet në vitet 2000. Një miksim i komedisë dhe dramës, bazuar në temat dhe personazhet e dramaturgut rus, një komedi ku përmbledhen ndjeshmëria tipike e tij, por dhe humori.

### PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 23.10.2014- 29.10.2014



#### SALLA 1

- "Fury " 2D/ 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Good People " 2D/ 13:00 / Çmimi 500 Leke
- "Let's Be Cops " 2D/ 22:45 / Çmimi 500 Leke
- "The Best Of Me " 2D/ 18:00 / Çmimi 500 Leke
- "Antboy" 2D/ 10:30 / Çmimi 500 Leke
- "Annabelle " 2D/ 15:30 / Çmimi 500 Leke

#### SALLA 2

- "Fury " 2D/ 16:00 / Çmimi 500 Leke
- "Good People " 2D/ 18:30 / Çmimi 500 Leke
- "Let's Be Cops " 2D/ 21:00 / Çmimi 500 Leke
- "The Best Of Me " 2D/ 13:30 / Çmimi 500 Leke
- "Annabelle " 2D/ 11:00 / Çmimi 500 Leke

## KINEMA AGIMI

- "Fury " 2D/ 17:30 / Çmimi 500 Leke
- "Good People " 2D/ 15:00 / Çmimi 500 Leke
- "Let's Be Cops " 2D/ 20:00 / Çmimi 500 Leke
- "Annabelle " 2D/ 12:30 / 22:00 / Çmimi 500 Leke
- "Antboy " 3D/ 10:00 / Çmimi 500 Leke

### PREMIERE BOTERORE DT. 30.10.2014

- 1- Northmen: A Viking Saga 2D
- 2-Open Windows 2D
- 3-Horns 2D

## » KONFERENCA

**STUDIUESJA** rrëfen botimet në kohën e Aldo Manuzio-s dhe kontributin në Venecia të botuesit me origjinë shqiptare të Marin Barleti-t. Vlerësime nga të pranishmit për studiuesen Nadin

# Nadin vijon zbulimet për Shqipërinë e 1500-s në Venecia

Massimo Gaiani: Librat e zonjës Nadin më kanë ndihmuar të kuptoj më mirë vlerat dhe historinë e shqiptarëve”

**DHURATA HAMZAI**  
TIRANË

**P**rofesoresha Lucia Nadin ka zhvilluar dje një konferencë brenda temës “Java e Gjuhës Italiane në Botë”, që këtë vit i dedikohet shtypit, e ajo konkretisht pati si objekt shtypin e viteve 1400-1500 në Venecia. Konferenca u mbajt dje paradite në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë me titull “Botimet Veneciane në kohën e Aldo Manuzio-s dhe vepërimitaria e Bernardino Vitali-t, publikues i Marin Barleti-t”. Ajo mbajti një ligjëratë shkencore që u organizua nga Instituti Italian i Kulturës në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, në kuadrin e javës së XIV të gjuhës italiane në botë, që sivjet i kushtohet temës “Të shkruash në Evropën e re: botuesit italianë, autorët, lexuesit në epokën dixhitale). Lucia Nadin, në kumtesën e saj, i është referuar shtypit në Venecia, duke e parë si “kryeqytetin evropian të librit mes shekujve XV dhe XVI”. Ligjëratën e saj Lucia Nadin e shoqëroi me fotografi e faksimile, dhe u ndal në figurën e Aldo Manuzio-s, si dhe në vepërimitarinë Bernardino Vitali, një venecian të cilit ajo i zbulon origjinën shqiptare, që ishte edhe botuesi i veprës së Marin Barletit. Lucia Nadin, veneciane, ka kontribuar në Shqipëri një periudhë të gjatë mësimdhënies dhe pune kërkimore. Ka përgatitur botimin e “Statuteve të Shkodrës” duke nxjerrë në dritë tekstin nga Biblioteka e Muzeut të Venecias, tashmë një “monument” i historisë mesjetare të Shqipërisë. Shkodra i ka dhënë titullin qytetare nderi në vitin 2000. Nadin ka shkruar librin për emigrimin shqiptar në krahinën e Venetos “Shqiptarët në Venedik, mërgim e integrim 1479 – 1552”, etj. Por studimet e saj nuk kanë vlerë vetëm për shqiptarët. Vetë ambasadori Italian, Massimo Gaiani, tha dje se “librat e zonjës Nadin, që i kam lexuar me kujdes, më kanë ndihmuar të kuptoj më mirë vlerat dhe historinë e shqiptarëve”. Ndërsa profesor Gjovalin Shkurtaj e ka e vlerësuar studiuesen Lucia Nadin si një figurë të dalluar si dashamirëse e shqiptarëve. “Ajo është mike dhe ndihmëtare e palodhur e të gjithë albanologëve: historianë, gjuhëtarë, kulturologë etj., që ajo i ka njohur qysh nga viti 1995, kur ishte punonjëse e Institutit të Kulturës Italiane në Tiranë”, tha



Studjuesja Lucia Nadin

Shkurtaj. Përmes kumtesës, rezultatet e studimit më të fundit Lucia Nadin ia dedikoi “Javës së Gjuhës Italiane në Botë”, që ka nisur më 20 tetor dhe nesër të shtunën, duke filluar nga ora 9.00, do të zhvillohet, pranë Sallës Nënë Tereza të Pallatit të Kulturës në Tiranë,

një seminar formimi për profesorët e italishtes të Programit Iliria me titull “Vlerësimi i aftësive gjuhësore-komunikative të italishtes si gjuhë e huaj”. Seminarin do të mbahet nga Prof. Sabrina Marchetti dhe nga Dr. Anna Bandini


e Universitetit të Siena-s. Nismave të programuara në Tiranë do t'i shtohen edhe ato të organizuara e Konsullatës së Përgjithshme në Vlorë dhe nga Konsullatet e Nderit në Shkodër, Gjirokastrë dhe Berat, në bashkëpunim me lektorët dhe seksionet dygjuhëshe.

### Kontributi

Lucia Nadin, veneciane, ka kontribuar në Shqipëri një periudhë të gjatë mësimdhënies dhe pune kërkimore. Ka përgatitur botimin e “Statuteve të Shkodrës” duke nxjerrë në dritë tekstin nga Biblioteka e Muzeut të Venecias, tashmë një “monument” i historisë mesjetare të Shqipërisë.

### Programi European

Projekt restaurimi, 61 mijë euro për Kalanë e Ali Pashës në Butrint



— Aktualisht kalaja e Ali Pashës në grykën e vivarit të Butrintit është një nga monumentet shumë pak i vizitueshëm nga turistët në parkun e Butrintit. Njëra arsye është se aty mund të shkohet vetëm më lundrim, dhe arsyeja tjetër, lenia e këtij monumenti në gjendje të shkatërruar. Kjo kala është fortifikuar nga vetë ali pasha për të përballuar sulmet e francezëve të vendosur në Korfuz gjatë viteve 1817-1818. Monumenti aktualisht është imbuluar nga shkurret, bimësia dhe mbeturinat. Për ta shpëtuar këtë nga kjo gjendje në Bashkinë e Sarandës na bëjnë me dije shumë shpejt në bazë të programit evropian, kalaja e Ali Pashës do të merret në konservim për t'u shndërruar në një aset turistik. Saspo është aprovuar faza e parë e projektit që do të pasohet më tej me ngritjen e një muzeu historik modest për figurën e Ali Pashë Tepelenës brenda ambienteve të kalasë dhe ndërtimin e një observatori për shpendët në këtë lagunë. Vlera e projektit të BE për kalanë e Ali Pashës shkon në 61 mijë euro. Ndërkohë që përmes këtij projekti synohet edhe rritja e numrit të turistëve në Parkun Kombëtar të Butrintit përmes paketave të përbashkëta turistike me vendet e rajonit.

### 150-VJETORI

## Vikena Kamenica e Deniola Kuraja, sot koncert në Korçë për Shtrausin

**I**mazhi muzikor i Richard Strauss (Rikard Shtraus) do të vijë në Shqipëri nga Ansambli Flex së bashku me mexosopranon e njohur Vikena Kamenica dhe pianisten Deniola Kuraja. 150 vjet Richard Strauss, kjo është logoja që shoqëron koncertin, i cili do të jepet të shtunën nga Ansambli Flex me Vikena Kamenica në orën 18.00 në Qendrën kulturore “Vangjush Mio”, Korçë. 2014-a është viti i Richard Strauss-it! Prej lindjes së kompozitorit të njohur në mbarë botën kanë kaluar tanimë 150 vjet. Një motiv mëse i mjaftueshëm që Ansambli Flex të sjellë në Shqipëri këngët dhe pjesët me muzikë dhome të Strauss-it. Ansambli Flex është i përbërë prej: Kana Sugimura

(violinë), Anna Szulc-Kapala (violë), Martha Bijlsma (çelo) dhe Endri Nini (piano). Një ansambël i ri në moshë por i vlerësuar me çmime, të cilët kanë gjetur njëri-tjetrin në nivel muzikor në Gjermani, në Akademinë e Muzikës, Teatrit dhe Mediave në Hanover - ku edhe muzikantët ndërkombëtarë kanë studiuar. Në Shqipëri Ansambli Flex së bashku me mexosopranon e njohur Vikena Kamenica dhe pianisten Deniola Kuraja do të sjellin krahas veprave të Strauss-it edhe pjesë të tjera nga Johannes Brahms dhe Gustav Mahler – në versione të degjuara trallë, përpunuar për kanto dhe ansambël për muzikë dhome.



PARADE FJALEKRYQESH NGA KADRI VOKOPOLA



VIDEO/ SI FOTOGRAFOHET CELESTE MURIEGA



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

HOROSKOPI

- Daishi, Demi, Binjakët, Gaforrija, Luani, Virgjëria, Peshorja, Akrepi, Shigjetari, Bricjapi, Ujori, Peshqit

Dite shume delikate kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Asgjë nuk ka për te ecur ashtu si e kishit ëndërruar dhe madje mund te vuani ne disa momente.

Ambienti ne çift do jete shume i ngrohte gjate kësaj dite. Do flisni për gjithcka dhe do bashkëpunoni fort me personin qe keni ne krah.

Nuk do jeni aspak ne humor gjate kësaj dite juve qe jeni ne një lidhje dhe do bëni çdo gjë qe te ndjeni vetëm për t'ia kaluar mire me partnerin.

Venusi, përendesha e dashurisë do kujdeset qe te keni një lidhje sa me te bukur dhe me emocionuese.

Do keni te njëjtat ide dhe mendime sot ju te dashuruarit prandaj gjërat do ecin me se miri ne çift. Do te sqaroni shpejt edhe mosmarrëveshjet e vogla qe ju kishin dale.

Nuk priten ndryshime te mëdha gjate kësaj dite për jetën tuaj sentimentale. Merrni gjërat sa me shtruar qe te mos keni as problem ne te vogël.

Ata qe janë ne një lidhje do bëjnë çmos qe ta përmirësojnë lidhjen dhe te krijojnë një klimë edhe me harmonike.

Mos bëni asgjë me force ose me inat ju te dashuruarit, por lëri gjërat te rrijdhen vete. Do e shihni qe do ndiheni edhe vete me te qete.

Dite e zakonshme dhe pa asgjë te veçante kjo e sotmja. Beni atë qe ndjeni pa menduar se gfarë mund te ndodhe me vone.

Sytë do ju shkëlqejnë sot juve te dashuruarve nga propozimet e mrekullueshme qe do merrni. Partneri do ju beje te ndiheni si mbi re.

Dite goxha e trazuar kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Shpeshherë nuk do kuptoheni me atë qe keni ne krah dhe do debatoni.

Pas një periudhe goxha te vështirë për sektorin e dashurisë sot me ne fund do rigjën qetësinë. Do merrni vesh me partnerin tuaj dhe do hapni rrugë ne çdo moment.

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 37 KUTI

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

HORIZONTAL

- 1. Inicialet e Presley-t. -I pëqente Narcozit -Për Coca dhe Pepsi 2. Jetojnë te vetmur.

VERTIKAL

- 1. Ente Humanitare Autonome. -... Di Saronno në shishe. 2. Eshhtë gjurmë... piktori

Pak familjaritet.

- Eshhtë thikë. 9. Inicialet e Travolta-s. -Ishin festat për nder të Apollonit.

Small crossword grid with the word 'PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË' written across it.

Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë

Sudoku

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

Përgjigje

9x9 grid containing the solution to the Sudoku puzzle.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Përgjigje

Small crossword grid for the cryptogram puzzle.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI SPORTIV

Large crossword grid for the sports-themed puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Mbyllin portat. 2. Mbyllin portat. 3. Vidal te Juventus.

Fillojnë fazën.

- 15. Janë faza sportive. 20. Fletë pa kufij. 22. Tare që hidhet diskun.

11. Në melar për... sipërfaqe.

- 33. Federer tenist. 35. Ndezur në aparatatur. 37. Celulari për shkurt.

43. Walter trainer italian.

- 43. Walter trainer italian.

VERTIKAL

- 1. Tase e volejbolit. 2. Fillojnë argumentin. 3. Fundi i një samurai.

Përgjigje e fjalëkryqit sportiv

Small crossword grid with the solution to the sports puzzle.

- 6. Në mes të rrugës. 7. ... Plate në futbollin argjentinas.

- 21. Roth aktor. 22. Daja trainer. 23. Kërkimi me... i Sergej Butka-s.

LAJME

nga botë

Jahjaga, përgjigje negative Bllokut

— Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, u ka kthyer përgjigje negative liderëve të LDK-së, AAK-së dhe NISMA-s, të cilët i kishin kërkuar që t'i drejtohej edhe një herë, për sqarime në lidhje me krizën institucionale, Gjykatës Kushtetuese. Duke u kujtuar atyre përgjegjësitë që kanë si deputetë për formimin e institucioneve shtetërore, që janë në ngërc, presidentja Jahjaga i ka ftuar që të mblidhen në një takim të përbashkët, ku të marrin pjesë gjithë liderët dhe të gjejnë zgjidhje konform Kushtetutës. Ndërkohë Avokati i Popullit ka akuzuar presidenten për bëri shkelje kushtetuese kur u zgjati mandatin tre gjyqtarëve ndërkombëtarë të kësaj Gjykate.

Londra refuzon pagesë shtesë për BE

— Londra dhe Brukseli janë përfshirë në një tjetër debat që rrit dozën e euroskeptikëve në Britaninë e Madhe. Bashkimi Europian i kërkoj qeverisë britanike të derdhë dy miliardë euro në llogarinë e BE-së brenda i dhjetorit, si pjesë e detyrimeve që ka ky vend ndaj Unionit. Por kryeministri Cameron e cilësoi kërkesën si absurde dhe tha se refuzon të bëjë një pagesë të tillë. Shuma ka dalë nga llogaritja e performancës së ekonomive, sipas formulës së vitit 1995. Britania, Holanda, Italia, Greqia e Qipro janë vendet, që u kërkohej kontributi në rritje, ndërkohë që reduktim ka për Francën, Gjermaninë, Danimarkën, Poloninë e Austrinë.

Putin akuzon SHBA për diktat botëror

— Presidenti Vladimir Putin ka akuzuar Shtetet e Bashkuara dhe po e kthejnë botën në një vend më të rrezikshëm, duke imponuar një "diktat të njëanshëm" në diplomacinë ndërkombëtare, ndërkohë që hodhi poshtë pretendimin se Rusia dëshiron të krijojë një perandori të re. Në një fjalim, të mbajtur me një gjuhë si ajo e Luftës së Ftohtë, Putin ia hodhi fajin Perëndimit për krizën në Ukrainë dhe e portretizoi Rusinë si një superfuqi që nuk do të detyrohet t'i lutet Perëndimit për të hequr sanksionet. Duke i quajtur këto sanksione si gabim, ai shtoi se "Rusia nuk do të kthehet në një kukull. Rusia është e zonja e vetes".

**Problematika dhe suksese**

**Bujqësi**

**Agrokulturë**

**Agroturizëm**

**Akuakulturë**

**Blegtori**

**Prezanton Alban Musa**

**A1 REPORT!**

**MADE IN ALBANIA**

**ÇDO TË SHTUNË 14:00 - 15:00**

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor  
Genc Kondi- Administrator i Përgjithshëm & Ekonomi ; Admirina Peçi- Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Ervin Koçi ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ;  
Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sport: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri ; Website: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini tel: +355696088847

Departamenti i Marketingut:  
Vera Përleka  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail:redaksia@shqiptarja.com -Website: www.shqiptarja.com -Mobile: +355696060421 -Shtypur në shtypshkronjën: KLAS5 shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë